

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS



# GUIDA

## E MATURËS SHTETËRORE DHE E SISTEMIT MERITË-PREFERENCË

### 2008

TIRANË Maj '2008



## **Përmbajtja:**

---

1. Hyrje
2. Udhëzime:
  - a) Udhëzimi Nr. 7, datë 11.02.2008 "Përfundimin e vitit shkollor 2007-2008, zhvillimin e provimeve përfundimtare dhe provimeve të maturës shtetërore, në sistemin e arsimit parauniversitar";
  - b) Udhëzimi Nr 344, datë 2.10.2007 "Provimet e detyruara të maturës shtetërore në shkollat e mesme tekniko-profesionale dhe social kulturore".
3. Rregullore për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2008
4. Materiale dhe programi i punës për Këshillimin për Karrierën
5. Shpjegime për llogaritjen e pikëve dhe shembuj konkretë



*Të dashur maturantë,*

*Tashmë ju jeni në prag të provimeve të Maturës Shtetërore, e cila në vitin e tretë të saj është edhe më e sprovuar, e konsoliduar dhe e përmirësuar.*

*Megjithëse kjo periudhë trevjeçare ju ka familjarizuar me këto provime, unë e kuptoj që shqetësimi, madje ankthi mbetet, deri në momentin që dorëzoni testin e mbushur të provimit, deri në momentin që merrni rezultatit. Por edhe shkolla, mësuesit tuaj, kanë bërë çmos që t'ju informojnë për të dhënat, modalitetet e procedurat e këtyre provimeve që ju të shkoni drejt tyre me informacion të plotë.*

*Ndërkohe ne kemi nismuar Këshillimin e Karrierës për ju: profesorë të universiteteve do të vijnë në shkollën tuaj dhe ju do të vizitoni fakultetet e ndryshme sipas preferencës, në mënyrë që të njiheni me pedagogët, programet e studimit, auditorët, laboratorët, me atë çfarë ata ofrojnë, me sfidat që ju presin dhe mundësisht edhe me ofertat e tregut të punës dhe shanset që do keni për tu punësuar. Pra vendimi që ju do merrni për të renditur preferencën tuaj nga nr. 1-shi deri te 10-ta të jetë i bazuar me një informacion sa më të plotë, që ky vendim i rëndësishëm për të ardhmen të jetë i peshuar mirë.*

*Zgjedhja e programit të studimit është një çështje e të qenit realist mes gjetjes së prirjeve të brendshme, dëshirës dhe rezultateve konkrete në shkollë, në përputhje me mundësitë që ofrojnë Institucionet e Arsimit të Lartë në vend, në mënyrë që gjithkush të shkojë aty ku dëshiron, aty ku ka të dhëna, ku ka mundësi dhe aty ku e meriton.*

*Prandaj nismat e "Ditët e maturantit në Universitete" dhe "Profesorët në shkolla" janë ndërmarrë për t'ju të mirinformuar rreth ofertës së Institucioneve të Arsimit të Lartë. Pra informacioni kësaj here nuk janë thjesht dhe vetëm tabelat me koeficiente, si instrumente kryesorë të sistemit Meritë-Preferencë (MeP), por një paraqitje me të dhëna shumë më të plota, që ofrojnë një njohje më të thellë të ofertës arsimore në mënyrë që vendimi juaj të jetë i ndërgjegjshëm.*

*Ju e dini, që arsimit është shpallur prioritet kryesor nga Qeveria dhe ne jemi të gjithë të ndërgjegjshëm se me një arsim masiv dhe cilësor, realizohet një shoqëri e nesërme më e avancuar, e aftë për të ecur*

*përpara me hapa më të shpejta dhe për të konkurruar në tregjet rajonale dhe globale.*

*Ky vullnet është materializuar me nisma, investime, reforma të ndryshme, me përpjekje të vazhdueshme për të modernizuar Arsimin e Lartë, për të rritur numrin e studentëve në të dhe për të ngritur në përgjithësi standardet e Institucioneve të Arsimit të Lartë në nivele që sot janë më të larta në krahasim me ato të tre viteve më para.*

*Prandaj të dashur maturantë, duke shpresuar që kemi bërë maksimumin e mundshëm për t'u gjendur pranë jush në këtë sfidë të rëndësishme të jetës suaj, ju uroj secilit prej jush suksese në Maturën Shtetërore dhe rezultate të mira në fakultetin që do te ndiqni!*

**Genc POLLO**

Ministër i Arsimit dhe Shkencës

## I. HYRJE

---

Pranimet në shkollat e larta për vitin shkollor 2007-2008, ashtu si dhe vitin e kaluar shkollor, do të bëhen në bazë të Maturës Shtetërore.

Nxënësit, mësuesit, prindërit dhe të gjithë të interesuarit, do të gjejnë në këtë Guidë informacionin e nevojshëm rreth Maturës Shtetërore, si:

- *Sqarime për provimet e detyruara dhe ato me zgjedhje;*
- *Sqarime për mënyrën e regjistrimit si kandidat në shkollat e larta;*
- *komponentëve përbërës të saj;*
- *Udhëzime për Lëndët e provimeve të detyruara për të gjitha llojet e shkollave të mesme dhe datat e zhvillimit të provimeve të maturës shtetërore;*
- *Materiale për këshillimin e karrierës - matura shtetërore 2008;*
- *Sqarime për mënyrën e llogaritjes së pikëve, etj.*

**MATURA SHTETËRORE**, nënkupton dhënien e katër provimeve, nga të cilat dy janë të detyruara dhe dy janë me zgjedhje.

Lëndët për provimet e detyruara për të gjitha shkollat e mesme (të përgjithshme) janë; “Letërsi dhe gjuhë shqipe” (“Letërsi” për shkollat profesionale) dhe “Matematikë”.

Lëndët për dy provimet me zgjedhje do të caktohen nga vetë maturanti (kandidatët për shkollë të lartë) duke i zgjedhur ato nga lista e lëndëve për provim me zgjedhje, të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

### **1. Provimet e detyruara**

Provimeve të detyruara do t'i nënshtrohen të gjithë nxënësit maturantë.

Maturantët e *Shkollave të mesme të përgjithshme me kohë të plotë dhe të shkurtuar*, do të japin provime të detyruara lëndë:

- MATEMATIKË

- LETËRSI DHE GJUHË SHQIPE (LETËRSI për shkollat profesionale).

Maturantët e *Shkollave të mesme artistike, koreografike, sportive, të seksioneve dygjuhëshe dhe të Shkollave teknike-profesionale 5 vjeçare dhe 3+2 vjeçare*, përveç dy provimeve të detyruara, do të japin dhe një provim të tretë, lëndën e FORMIMIT PRAKTIK PROFESIONAL i cili është provim shkollor në specialitet dhe nuk bën pjesë në llogaritjet e pikëve për pranimet në shkollat e larta.

Nxënësit maturantë të shkollave profesionale dhe social-kulturore, të cilët nuk do të vazhdojnë studimet në shkollat e larta, do të japin vetëm dy provime:

- Provimi i detyruar: Matematika për shkollat profesionale dhe Letërsia për shkollat social-kulturore;
- Provimi shkollor: FORMIMIT PRAKTIK PROFESIONAL.

Në përfundim të dy provimeve nxënësi pajiset me Dëftesë Pjekurie.

Për informacion të hollësishëm, lexoni Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Nr 344, datë 2.10.2007 “Për provimet e detyruara të maturës shtetërore në shkollat e mesme tekniko-profesionale dhe social kulturore”.

## **2. Provimet me zgjedhje**

Provimeve me zgjedhje do t’u nënshtrohen ata nxënës maturantë, të cilët në përfundim të shkollës së mesme, duan të vazhdojnë studimet në shkollat e larta.

Këta maturantë, pavarësisht nga lloji i shkollës së mesme që kanë kryer (shkollë e mesme e përgjithshme, teknike-profesionale, social-kulturore apo me kohë të shkurtuar), do të japin dy provime me zgjedhje, të cilat i zgjedhin vetë nga lëndët e poshtëshënuara:

1. Histori
2. Gjeografi
3. Njohuri për shoqërinë
4. Njohuri për ekonominë + Filozofi
5. Gjuhë angleze
6. Gjuhë frënge
7. Fizikë
8. Kimi
9. Biologji

***Provimet e detyruara dhe provimet me zgjedhje do të jenë vetëm me shkrim.***

***Testet për këto provime do të hartohen dhe administrohen nga Agjencia qendrore e Vlerësimit të Arritjeve të nxënësve (AVA).***

Për provimet e detyruara dhe ato me zgjedhje maturantët do të përgatiten me Programet orientuese lëndore, të cilat janë dërguar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Drejtoritë Arsimore Rajonale Zyrat e Arsimit të rretheve dhe këto të fundit i kanë dërguar në të gjitha shkollat e mesme që janë në juridiksionin e tyre. Ato do t'i gjeni edhe në internet në faqen e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me adresë: [www.mash.gov.al](http://www.mash.gov.al); Matura Shtetërore.

***Përcaktimi i dy provimeve me zgjedhje dhe caktimi i programeve të studimit të shkollave të larta ku do të donit të regjistroheshit***

1. Tashmë maturantët dhe kandidatët për vazhdimin e shkollës së lartë, kanë plotësuar Formularin A1, nëpërmjet të cilit, secili ka përcaktuar 2 (dy) lëndët provim me zgjedhje, të cilat i ka përzgjedhur nga lista e lëndëve për provim me zgjedhje, në varësi të programit të studimit që do të vazhdojë në shkollë të lartë si dhe të koeficienteve që shkollat e larta u kanë vënë.
2. Gjatë muajit Qershor 2008 nxënësit që dëshirojnë të vazhdojnë shkollën e lartë do të plotësojnë pranë shkollave të tyre Formularin A2. Në këtë formular nxënësi ka të drejtë të caktojë deri në 10 (dhjetë) degë (programe studimi) të shkollave të larta, të renditura ato sipas preferencës, duke filluar kështu nga dega më e preferuar dhe duke zbritur deri tek dega e fundit e preferuar. Formulari do të vijë në shkollat e mesme i shoqëruar me një udhëzues shpjegues për plotësimin e tij.

***Nxënësit maturantë që mbeten me riprovim në sesionin e dytë:***

Nxënësi, i cili është mbetës qoftë edhe në një nga provimet e detyruara të Maturës Shtetërore në sesionin e parë, nuk ka të drejtë të futet në provimet me zgjedhje.

Ky nxënës duhet të japë riprovim lëndët e detyruara në sesionin e dytë dhe, në qoftë se i merr ato, ka të drejtë të futet në provimet me zgjedhje vitin e ardhshëm.

### ***Këshillimi për karrierën***

Në këtë në Guidë janë përfshirë materiale që do t'u vinë në ndihmë nxënësve maturantë (kandidatëve për shkollë të lartë) për të marrë informacione, të cilat shërbejnë për të bërë një zgjedhje më të mirë të programeve të studimit, sipas preferencave personale të nxënësve.

## II. UDHËZIME

---



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

---

### UDHËZIM

*Nr 7, Datë 11.02. 2008*

#### **PËR**

#### **PËRFUNDIMIN E VITIT SHKOLLOR 2007-2008, ZHVILLIMIN E PROVIMEVE PËRFUNDIMTARE DHE PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE, NË SISTEMIN E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Në zbatim të nenit 102 të Kushtetutës, të Ligjit Nr. 7952, datë 21.06.1995 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar” i ndryshuar dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 78 datë 08.02.2006 “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta”, i ndryshuar,

#### **UDHËZOJ:**

##### KREU 1

#### **PËRFUNDIMI I VITEVE TË FUNDIT TË SHKOLLAVE TË MESME DHE PERIUDHA E ZHVILLIMIT TË PROVIMEVE PËR SESIONIN E PARË**

1. Për vitet e fundit të shkollave të mesme të përgjithshme, që do t'i nënshtrohen provimeve të Maturës Shtetërore, viti mësimor 2007-2008 përfundon më 30 Maj 2008.
2. Për vitet e fundit të shkollave të mesme social kulturore dhe tekniko - profesionale, që do t'i nënshtrohen provimeve të Maturës Shtetërore, viti mësimor 2007-2008 përfundon më 23 Maj 2008. Provimet shkollore zhvillohen nga 24 - 31 Maj 2008,

duke pasur parasysh edhe Urdhrin Nr 344, datë 2.10.2007 “Provimet e detyruara të Maturës Shtetërore në shkollat e mesme tekniko-profesionale dhe social kulturore”. Viti shkollor reduktohet me dy javë mësimore.

3. Periudha e zhvillimit të provimeve për sesionin e parë, për Provimet e Maturës Shtetërore është 1 Qershor 2008 deri më 10 korrik 2008.

4. Periudha e zhvillimit të provimeve për sesionin e parë, për Provimet Përfundimtare në shkollat profesionale 3-vjeçare dhe në nivelin e parë 3-vjeçar të shkollave profesionale 3+2-vjeçare është 16 Qershor 2008 deri më 1 Korrik 2008.

## KREU 2

### **SESIONI I PARË I PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE**

1. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore për sesionin e parë janë si më poshtë:

1.1 Në shkollat e mesme të përgjithshme, me kohë të plotë ose të shkurtuar:

a- Letërsi dhe gjuhë shqipe	9 Qershor 2008
b- Matematikë	17 Qershor 2008
c- Lëndët me zgjedhje	10 Korrik 2008

1.2 Në shkollat e mesme pedagogjike:

a- Letërsi dhe gjuhë shqipe	9 Qershor 2008
b- Matematikë	17 Qershor 2008
c- Lëndët me zgjedhje	10 korrik 2008

1.3 Në shkollat e mesme pedagogjike për minoritetin:

a- Gjuha dhe letërsia greke	2 Qershor 2008
b- Letërsi dhe gjuhë shqipe	9 Qershor 2008
c- Matematikë	17 Qershor 2008
d- Lëndët me zgjedhje	10 Korrik 2008

1.4 Në shkollat e mesme të gjuhëve të huaja:

a- Letërsi dhe gjuhë shqipe	9 Qershor 2008
b- Matematikë	17 Qershor 2008
c- Lëndët me zgjedhje	10 Korrik 2008

1.5 Në seksionet dygjuhëshe (Profili shoqëror dhe natyror):

a- Letërsi dhe gjuhë shqipe	9 Qershor 2008
-----------------------------	----------------

- |                       |                 |
|-----------------------|-----------------|
| b- Matematikë         | 17 Qershor 2008 |
| c- Lëndët me zgjedhje | 10 Korrik 2008  |
- 1.6 Në shkollat e mesme social-kulturore artistike dhe sportive:
- |                             |                 |
|-----------------------------|-----------------|
| a- Letërsi dhe gjuhë shqipe | 9 Qershor 2008  |
| b- Matematikë               | 17 Qershor 2008 |
| c- Lëndët me zgjedhje       | 10 Korrik 2008  |
- 1.7 Në shkollat e mesme teknike ekonomike dhe teknike-profesionale 5- vjeçare dhe 3+2-vjeçare:
- |                       |                 |
|-----------------------|-----------------|
| a- Letërsi            | 9 Qershor 2008  |
| b- Matematikë         | 17 Qershor 2008 |
| c- Lëndët me zgjedhje | 10 Korrik 2008  |
2. Lëndët për provim me zgjedhje në Maturën Shtetërore janë si më poshtë:
- 2.1 Fizikë
  - 2.2 Kimi
  - 2.3 Biologji
  - 2.4 Anglisht
  - 2.5 Frëngjisht
  - 2.6 Histori
  - 2.7 Gjeografi
  - 2.8 Njohuri për shoqërinë
  - 2.9 Njohuri për ekonominë dhe Filozofi.

### KREU 3

#### **PROVIMET PËRFUNDIMTARE NË ARSIMIN PROFESIONAL**

1. Në Arsimin Profesional 3- vjeçar dhe në nivelin e parë 3-vjeçar të shkollave profesionale 3+2-vjeçare provimet përfundimtare janë:
  - a- Formimi teorik profesional
  - b- Formimi praktik profesional
2. Tezat përgatiten nga shkollat.
3. Datat për provimet caktohen nga drejtoritë e shkollave.

#### KREU 4

### **SESIONI I DYTË I PROVIMEVE TË DETYRUARA TË MATURËS SHTETËRORE**

1. Lëndët dhe datat për sesionin e dytë të provimeve të detyruara të Maturës Shtetërore, për të gjitha shkollat e mesme të përgjithshme dhe shkollat profesionale 5-vjeçare dhe 3+2 vjeçare janë si më poshtë:

a. Letërsi

9 Tetor 2008

b. Matematika

15 Tetor 2008

2. Për nxënësit e klasave të katërta të shkollave të arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe të shkollave social-kulturore, të klasave të pesta të shkollave teknike, të klasave të treta të shkollave profesionale (me kohë të plotë) dhe të klasave të pesta të shkollave të mesme të përgjithshme (me kohë të shkurtuar), të cilët kanë mbetur në klasë në një apo dy lëndë zbatohen "Dispozitat Normative të Shkollave Publike" Kreu V, Neni 29, Pika 4.

#### KREU 5

### **MASA PËR MBARËVAJTJEN E PROVIMEVE**

1. Drejtoritë Arsimore Rajonale, Zyrat Arsimore (DAR/ZA) dhe Drejtoritë e Shkollave të mesme marrin të gjitha masat që viti mësimor 2007-2008, për klasat e maturës (4/5), të mbyllet *me programe të realizuara* brenda datës 30 Maj 2008, duke shfrytëzuar orët në dispozicion dhe ditët e shtuna. *Notat përfundimtare* për çdo lëndë të nxirren brenda datës 30 Maj 2008. Në periudhën javore 2 - 7 Qershor të *zhvillohen konsultime* me të gjithë nxënësit për dy provimet e detyruara. Për provimet me zgjedhje konsultimet e grupuara sipas lëndëve me nxënësit të zhvillohen pas përfundimit të provimeve të detyruara.
2. Çdo DAR/ZA dërgon, brenda datës 2 Qershor 2008, në Agjencinë qendrore të Vlerësimit të Arritjeve të nxënësve (AVA) emrat e nxënësve të klasifikuar mbetës në përfundim të vitit të fundit (të katërt ose të pestë), me qëllim që të hiqen nga lista e provimeve të detyruara.

3. Për provimet e Maturës Shtetërore të veprohet sipas Rregullores për Maturën Shtetërore në Republikën e Shqipërisë.
4. Të gjitha testet e provimeve me shkrim, për të dy sesionet hartohen në AVA dhe shpërndahen prej saj.
5. Në institucionet arsimore private, provimet e Maturës Shtetërore me shkrim zhvillohen në të njëjtat data dhe me të njëjtat teste si dhe në institucionet ekuivalente publike.
6. Për shkollën e mesme pedagogjike për minoritetin grek për provimin Gjuha dhe letërsia greke përgatitet tezë e veçantë nga DAR Gjirokastrë.
7. Tërheqja e testeve të provimeve me shkrim të Maturës Shtetërore bëhet sipas Rregullores së Zhvillimit të Provimeve të Maturës Shtetërore.
8. Për ndjekjen e provimeve përfundimtare në shkollat profesionale 3-vjeçare, DAR dhe ZA angazhon inspektorët dhe specialistët përkatës sipas profileve.

## KREU 6

### **KËSHILLIMI I KARRIERËS**

1. Në bazë të pikës 12.3, të Rregullores “Për Maturën Shtetërore në Republikën e Shqipërisë” miratuar me Urdhrin e Ministrit, Nr 729 datë 1.2.2008, zëvendës drejtori i shkollës është anëtar i KSHMSH. Në ato shkolla të mesme të cilat kanë zëvendës drejtor, ai ngarkohet të kryejë rolin e këshilluesit për karrierën në shkollë dhe në ato shkolla që nuk kanë zëvendës drejtor këtë rol do ta kryejë drejtori i shkollës.
2. Këshilluesi për karrierën në shkollë ngarkohet me detyrat e mëposhtme:
  - a) *Të informojë nxënësit (në grup ose individualisht) për të gjitha dokumentet e maturës shtetërore, të dërguara nga MASH.*
  - b) *Të sqarojë nxënësit (dhe prindërit nëse ata kërkojnë) për sistemin meritë-preferencë dhe funksionimin e tij.*
  - c) *Të orientojë nxënësit për plotësimin e Formularëve A1 dhe A2 (të cilët shoqërohen me udhëzues të hollësishëm) dhe t'i sqarojnë ata për pasojat në rastet e mosnjohjes së sistemit meritë-preferencë.*

3. Zëvendësdrejtorit, të cilit do t'i ngarkohet këshillimi i karrierës, në kuadër të KMKSH, do t'i zbritet norma e kontrollit me 4 orë në javë, duke filluar nga data e daljes së këtij udhëzimi.

#### KREU 7

### **DISPOZITAT E FUNDIT**

1. Udhëzimi Nr. 23, datë 23.08.2007 "Për zbatimin e planeve, programeve dhe teksteve mësimore të arsimit parauniversitar në vitin shkollor 2007-2008", në lidhje me përfundimin e vitit mësimor 2007-2008 për vitet e fundit të shkollave të mesme 4 dhe 5- vjeçare dhe në lidhje me periudhën e zhvillimit të provimeve për sesionin e parë shfuqizohet.
2. Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen Sekretarja e Përgjithshme, Zëvendës Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Kurrikulës, Drejtoria e Inspektimit, Drejtoria e Planifikimit Buxhetor, Agjencia Qendrore e Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore.

*Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".*

**MINISTËR  
GENC POLLO**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

---

**URDHËR**

*Nr. 344 Datë 2.10.2007*

**PËR**

**PROVIMET E DETYRUARA TË MATURËS SHTETËRORE NË  
SHKOLLAT E MESME TEKNIKO-PROFESIONALE DHE SOCIAL  
KULTURORE**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të Ligjit Nr. 7952 datë 21.06.1995 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar” i ndryshuar; të Vendimit Nr. 78 datë 8.02.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimeve në shkollat e larta publike” i ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Provimet e detyruara të Maturës Shtetërore për vitin shkollor 2007-2008 për shkollat e mesme tekniko-profesionale dhe social-kulturore të jenë:
  - a) Letërsi dhe gjuhë shqipe
  - b) Matematikë
2. a) Për shkollat e mesme tekniko-profesionale, sportive, artistike dhe seksionet dygjuhëshe përveç dy provimeve të detyruara të Maturës Shtetërore, të jepet dhe provimi shkollor “Formimit teorik dhe praktik profesional”.
  - b) Provimi shkollor organizohet nga drejtorja e shkollës sipas degëve (specialiteteve).
  - c) Provimi shkollor zhvillohet sipas programeve orientuese të secilës degë (specialiteti), të hartuara në vitet 2006, 2007, për provimin e detyruar të Maturës Shtetërore “Lëndët e formimit teorik profesional”.
3. Për shkollat profesionale 3+2 vjeçare dhe teknike 5-vjeçare provimi shkollor të zhvillohet në javën e parë të qershorit. Për këtë të përdoret një javë nga praktika e grupuar.

4. Për shkollat mesme sportive, artistike dhe seksionet dygjuhëshe, provimi shkollor “Formimi teorik dhe praktik profesional”, të zhvillohet në javën e parë të qershorit, duke reduktuar vitin shkollor me një javë mësimore.
5. Drejtoritë e shkollave t’u bëjnë të njohur nxënësve maturantë, programin e provimit shkollor të “Formimit teorik dhe praktik profesional”, deri më 20 Tetor 2007.
6. IKT të përgatisë programet orientuese për provimet e detyruara mbi bazën e programeve të lëndëve matematikë dhe letërsi dhe gjuhë shqipe, që zhvillohen në shkollat e mesme tekniko-profesionale e social-kulturore dhe të dërgohen: një kopje në MASH, dhe nga një kopje DAR/ZA, brenda muajit Tetor 2007.
7. DAR/ZA të dërgojnë në shkollat përkatëse programet orientuese të provimeve të detyruara. Drejtoritë e shkollave t’ua bëjnë menjëherë të njohur programet nxënësve.
8. Drejtoritë e shkollave, duke filluar nga muaji dhjetor 2007, mbi bazën e programeve orientuese, të planifikojnë konsultime me nga një orë në javë:
  - a) Për provimin e detyruar ”Letërsi dhe gjuhë shqipe”, për shkollat teknike 5 vjeçare dhe profesionale 3+2 vjeçare;
  - b) Për provimin e detyruar “Matematikë”, për shkollat artistike, sportive, gjuhë të huaja.
9. Mësuesit që i zhvillojnë orët e konsultimeve mbi normën e ngarkesës mësimore, të paguhen sipas dispozitave përkatëse.
10. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri: Zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Kurrikulës, Drejtoria e Menaxhimit të Përditshëm, Drejtoria Ekonomike, Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimit, si dhe Drejtoritë Arsimore Rajonale e Zyrat Arsimore.

*Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.*

**GENC POLLO**  
**MINISTËR**

### III. RREGULLORE E MATURËS SHTETËRORE 2008

---



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

---

Nr. 729 Prot.

Tiranë, më 01.02.2008

#### **RREGULLORE PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

#### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

##### Neni 1

Kjo Rregullore përcakton rregullat e zhvillimit të provimeve të Maturës Shtetërore, institucionet shtetërore dhe strukturat arsimore përgjegjëse për këtë proces.

##### Neni 2

*Në kuptimin e kësaj rregulloreje:*

- 2.1 “Matura Shtetërore” (më poshtë do të quhet Maturë) është një standard i njësuar dhe i përgjithshëm provimesh të detyruara dhe me zgjedhje që vërtetojnë mbarimin e shkollës së mesme dhe japin të drejtën për të hyrë në shkollat e larta, në përputhje me procedurat përkatëse të pranimit.
- 2.2 “Shkollë e mesme” quhet shkolla publike dhe private, 4 (katër) ose 5 (pesë) vjeçare.
- 2.3 “Maturant” është individ i që vazhdon vitin e fundit të shkollës së mesme ose e ka përfunduar atë, por nuk ka marrë dëftesën e pjekurisë.
- 2.4 “Kandidat” është nxënësi që ka marrë Dëftesën e pjekurisë dhe jep provimin me zgjedhje.
- 2.5 “AVA” është Agjencia qendrore e Vlerësimit të Arritjeve të nxënësve.
- 2.6 “DAR” është Drejtoria Arsimore Rajonale; “ZA” është Zyra Arsimore.

- 2.7 “KMSH” i DAR/ZA është Komisioni i Maturës Shtetërore pranë DAR-it ose ZA-së.
- 2.8 “KSHMSH” është Komisioni Shkollor i Maturës Shtetërore.
- 2.9 “PAP” është Përgjegjësi i Administrimit të Provimit.
- 2.10 “AP” është Administratori i Provimit.
- 2.11 “AS” është Administratori i Sekretimit.
- 2.12 “PTP” është Përgjegjësi i Testit Përfundimtar.
- 2.13 “KOPOTED” është Komisioni për shqyrtimin e testeve që dyshohen për kopjim.

### Neni 3

Autoriteti shtetëror përgjegjës për zhvillimin e provimeve të Maturës është Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe institucionet e saj të varësisë.

### Neni 4

Komiteti i Maturës Shtetërore (KMSH) është organ këshillimor dhe mbikëqyrës pranë Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës dhe përfaqëson grupet e interesit në lidhje me Maturën.

Anëtarët e Komitetit të Maturës Shtetërore zgjidhen nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës një herë në dy vjet.

### Neni 5

*Institucionet e varësisë së Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, përgjegjëse për zhvillimin e provimeve të Maturës janë:*

- a. Agjencia qendrore e Vlerësimit të Arritjeve të nxënësve (AVA)
- b. Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore (DAR dhe ZA)
- c. Drejtoritë e shkollave të mesme

### Neni 6

*AVA lidhur me zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore kryen detyrat e mëposhtme:*

- 6.1. Harton teste të standardizuara.
- 6.2. Trajnon anëtarët e KMSH-ve të DAR-ve dhe ZA-ve si dhe individë të tjerë të përfshirë në zhvillimin e provimeve të Maturës.
- 6.3. Boton materiale ndihmëse për provimet e Maturës.
- 6.4. Shumëfishon të gjitha materialet e provimeve të Maturës.
- 6.5. Kryen paketimin e materialeve të provimeve.
- 6.6. Harton grafikun e shpërndarjes dhe grumbullimit të materialeve të provimeve të Maturës.

- 6.7. Organizon dhe realizon vlerësimin e testeve.
- 6.8. Emëron vlerësuesit e jashtëm të testeve.
- 6.9. Shpall rezultatet e arritjeve të çdo nxënësi/kandidati në provimet e Maturës.
- 6.10. Arkivon çdo material të provimit dhe i ruan ato për 6 muaj në mjediset e institucionit.
- 6.11. Përgatit raportin publik mbi arritjet e nxënësve në provimet e Maturës.
- 6.12. Kryen veprimet financiare për hartimin dhe vlerësimin e testeve në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe detyrat e saj.

#### Neni 7

*Për zhvillimin normal të provimeve të Maturës ngrihen këto komisione të përkohshme:*

- 7.1. Komisionet e hartimit të programeve orientuese lëndore të Maturës.
- 7.2. Komisioni i Maturës Shtetërore i DAR-it, ZA-së (KMSH-ja e DAR-it dhe ZA-së).
- 7.3. Komisioni Shkollor i Maturës Shtetërore (KSHMSH ).

#### Neni 8

Komisionet e hartimit të programeve orientuese lëndore ngrihen nga IKT. Secili prej tyre, për provimet e detyrueshme dhe ato me zgjedhje, shkruan programin orientues lëndor për nxënësit dhe grupin që harton testin lëndor të provimit të Maturës. Programet orientuese lëndore për provimet e detyrueshme dhe ato me zgjedhje miratohen nga MASH.

#### Neni 9

Komisioni i Maturës Shtetërore pranë DAR-it dhe ZA-së ngrihet deri më 5 Shkurt dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, ku kryetar është drejtori i DAR-it dhe i ZA-së dhe 4 (katër) anëtarë të tjerë, punonjës të këtyre institucioneve që punojnë në sektorët e trajnim-kualifikimit, inspektimit, burimeve njerëzore, këshillimit pedagogjik dhe të statistikës.

**Drejtori i DAR/ZA, PAP dhe AP, me caktimin në detyra që lidhen me zhvillimin e procesit të Maturës Shtetërore, janë të detyruar të pranojnë, me anë të një deklaratë personale, që nuk kanë fëmijë, nipër/mbesa maturanë të përfshirë në provimet e Maturës në njësinë ku ushtrojnë funksione që lidhen me realizimin e provimeve të kësaj Mature.**

## Neni 10

*Komisioni i Maturës pranë DAR-it dhe ZA-së kryen këto detyra:*

- 10.1. Miraton përbërjen e Komisionit Shkollor të Maturës Shtetërore (KSHMSH);
- 10.2. Koordinon veprimet ndërmjet MASH-it, AVA-s dhe KSHMSH-së;
- 10.3. Pajis KSHMSH-në me dokumentacionin përgatitor për zhvillimin e provimit të Maturës, të miratuar nga MASH-i dhe AVA;
- 10.4. Trajnon anëtarët e KSHMSH-ve sipas detyrave të ngarkuara;
- 10.5. Dorëzon në afat nga AVA në KSHMSH dhe anasjelltas, çdo material të provimit të Maturës në përputhje me këtë Rregullore;
- 10.6. Krijon Bazën e të dhënave për plotësimin e dokumentacionit përkatës;
- 10.7. Evidenton dhe cakton mjediset ku zhvillohen provimet e Maturës;
- 10.8. Harton listën e përgjegjësve të administrimit, të administratorëve të provimit e të sekretimit të provimeve të Maturës;
- 10.9. Organizon në mjediset e saj shortin për shpërndarjen në çdo mjedis të provimeve, të çdo përgjegjësi të administrimit të provimeve, të çdo administratori të provimeve dhe sekretimit, 3 (tre) orë para zhvillimit të çdo provimi të Maturës;
- 10.10. Dërgon pranë çdo KSHMSH-je rezultatet e çdo nxënësi/kandidati dhe çdo dokument të përfundimit të Maturës, të dërguar nga AVA;
- 10.10 Shqyrton dhe vendos për shkeljen e çdo rregulli të administrimit të provimit të Maturës, bazuar në informacionin me shkrim të dërguar nga përgjegjësi i administrimit të provimit;
- 10.11 KSHMSH-ja, 3-5 ditë pas mbarimit të çdo provimi, dorëzon në AVA, zyrtarisht, në fletë dhe kopje elektronike, listën e plotë të emrave të PAP, administratorëve të provimit dhe të sekretimit, për çdo mjedis, të ndarë sipas mjedisëve dhe sallave ku ata kanë qenë administratorë, ku shënohet dhe numri i nxënësve që ka pasur në administrim;

- 10.12. KMSH-ja pranë DAR/ZA, organizon procesin e këshillimit të nxënësve për plotësimin e formularëve A1, A2 në përputhje me interesat e tyre për përzgjedhjen e shkollave të larta që duan të vazhdojnë;
- 10.13. KMSH-ja pranë DAR -it dhe ZA-së kryen edhe detyra të tjera që dalin në zbatim të kësaj Rregulloreje si edhe udhëzimeve të tjera të dala nga MASH.

#### Neni 11

Komisioni Shkollor i Maturës Shtetërore ngrihet deri më 10 Shkurt dhe përbëhet nga 3 (tre) deri në 5 (pesë) anëtarë, në varësi të numrit të maturantëve të çdo shkolle.

Kryetari i këtij komisioni është drejtori i shkollës. Anëtarët e tjerë zgjidhen nga personeli i shkollës. Në këtë komision përfshihet edhe një nga zv.drejtorët e shkollës, nëse ka të tillë.

#### Neni 12

*Komisioni Shkollor i Maturës Shtetërore kryen këto detyra:*

- 12.1 Afishon në mjediset e shkollës të gjitha dokumentet dhe informacionin e nevojshëm për zhvillimin e provimeve të Maturës.
- 12.2 Pajis çdo nxënës me formularin A<sub>1</sub> dhe çdo kandidat të interesuar me formularin A<sub>2</sub>.
- 12.3 Ndhmon dhe sqaron çdo nxënës/kandidat për provimet e Maturës dhe për plotësimin e formularëve A<sub>1</sub> dhe A<sub>2</sub>. në përputhje me interesat e tyre për përzgjedhjen e shkollave të larta që duan të vazhdojnë.
- 12.4 Siguron saktësinë e plotësimit të formularëve A<sub>1</sub> dhe A<sub>2</sub> në tërësi dhe për pjesën që plotësohet nga shkolla, në veçanti.
- 12.5 Merr në dorëzim formularët A<sub>1</sub>, A<sub>2</sub> dhe Mandat-arkëtimet që dorëzohen nga çdo nxënës.
- 12.6 Hedh të dhënat e nxënësve në tabelën përmbledhëse të listës emërore të nxënësve që do të marrin pjesë në provimet e detyruara dhe me zgjedhje (Tabela T).
- 12.7 Dorëzon në afat në KMSH-në e DAR-it dhe ZA-së formularët A<sub>1</sub> dhe A<sub>2</sub>, të plotësuar prej çdo nxënësi/kandidati, së bashku me tabelën e regjistrimeve.
- 12.8 Shpall listën e nxënësve/kandidatëve që japin provime të detyruara dhe me zgjedhje.

- 12.9 Shpall listën e mjediseve ku do të zhvillohen provimet; informon me shkrim çdo nxënës/kandidat për mjedisin ku do të zhvillohen provimet e Maturës.
- 12.10 Organizon dhe rregullon mjediset/sallat e provimeve 5 (pesë) ditë përpara datës së çdo provimi të Maturës.
- 12.11 Informon KMSH-në në DAR/ZA për numrin e individëve që nevojiten për administrimin dhe sekretimin e provimeve të Maturës, në përputhje me mjediset e caktuara nga KMSH-ja e DAR-it dhe ZA-së
- 12.12 Plotëson dhe jep Dëftesën e përfundimit të shkollës së mesme.
- 12.13 KSHMSH-ja kryen edhe detyra të tjera që dalin gjatë zbatimit të kësaj Rregulloreje si edhe prej udhëzimeve të tjera të dala nga MASH ose AVA.

## **I. PROCEDURAT E PROVIMIT TË MATURËS**

### Neni 13

Provimet e Maturës zhvillohen pas përfundimit të procesit mësimor të shkollës së mesme.

### Neni 14

- 14.1 Provimet e Maturës përbëhen nga provime të detyrueshme dhe me zgjedhje.
- 14.2 Provimet e detyrueshme zhvillohen në ditë të ndryshme.
- 14.3 Provimet me zgjedhje zhvillohen në një ditë.
- 14.4 Provimet me zgjedhje zhvillohen vetëm një herë në vit.
- 14.5 Provimet e Maturës zhvillohen vetëm me shkrim

### Neni 15

Datat e provimeve të Maturës caktohen nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës.

### Neni 16

Provimet e detyruara të Maturës i jep çdo nxënës që ka përfunduar vitin e fundit të shkollës së mesme dhe ka plotësuar formularin A<sub>1</sub>.

Çdo nxënës mbetës në provimet e detyruara ka të drejtën e riprovimit në sesionin e dytë (të vjeshtës).

### Neni 17

Çdo nxënës që ka vlerësimin kalues në të dy provimet e detyruara dhe dëshiron të vazhdojë shkollën e lartë, jep edhe provimet me zgjedhje.

Nxënësi, i cili është mbetës qoftë edhe në një nga provimet e detyruara të Maturës Shtetërore në sesionin e parë, nuk ka të drejtë të futet në provimet me zgjedhje. Ky nxënës duhet të japë riprovim lëndët e detyruara në sesionin e dytë dhe, në qoftë se i merr ato, ka të drejtë të futet në provimet me zgjedhje vitin e ardhshëm.

#### Neni 18

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, organizon ruajtjen e mjediseve të provimeve dhe të AVA-së.

## **II. PROCEDURA E PËRGATITJES SË TESTEVE NGA AVA**

#### Neni 19

*Për të gjitha lëndët e provimeve të detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore në sesionin e parë veprohet sipas kësaj procedure:*

- 19.1. DZHK-ja në MASH dërgon zyrtarisht në AVA programet orientuese lëndore të hartuara nga komisionet e ngritura sipas Nenit 8 të kësaj Rregulloreje.
- 19.2. Pas marrjes së programeve orientuese, drejtori i AVA miraton ngritjen e grupeve lëndore të hartimit të testeve. Me propozimin e specialistëve lëndorë të AVA ai emëron anëtarët e grupeve lëndore të hartimit të testeve. Ata angazhohen në punë pas nënshkrimit të kontratave të posaçme, të cilat vënë si kusht ruajtjen e sekretit dhe mungesën e konfliktit të interesit.
- 19.3. Specialistët lëndorë të AVA-së trajnojnë çdo anëtar të grupeve lëndore të hartimit të testeve, pas emërimit të tyre.
- 19.4. Çdo grup lëndor harton fondin e kërkesave të testeve, bazuar në matricën e specifikimeve, të hartuar nga specialisti lëndor. Ky fond është sa 10 (dhjetëfishi) i kërkesave që do të përmbajë testi.
- 19.5. Pilotimi i njohjes së karakteristikave të kërkesave, procedurave logjistike dhe administrative për realizimin e provimit kryhet nga fondi i kërkesave të hartuara nga çdo grup lëndor, nën drejtimin e specialistit lëndor.
- 19.6 Përzgjedhja e testit të lëndës bëhet nga specialistë të caktuar prej Ministrit të Arsimit e Shkencës, që emërtohen përgjegjës të testit përfundimtar (PTP), në kushtet e ruajtjes së plotë të sekretit (KOEPS), brenda

ambienteve të izoluarat të AVA. Menjëherë pas përzgjedhjes së testit kryhet shumëfishimi dhe paketimi i Test-broshurave.

### **III. PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR PROVIMET E MATURËS**

#### **Neni 20**

*MASH miraton deri më datë 10 Shkurt:*

- 20.1 Formularin A<sub>1</sub> (të dhënat e kandidatit dhe kërkesa e tij për provimet e lëndëve me zgjedhje).
- 20.2 Udhëzuesin e formularit A<sub>1</sub>.
- 20.3 AVA dërgon në KMSH-në e DAR-it dhe ZA-së formularët A<sub>1</sub>, udhëzuesit për ta dhe modelin për përmbledhjen e të dhënave nga formularët A<sub>1</sub>. KMSH-të e DAR-ve dhe ZA-ve i dërgojnë ato në KSHMSH-të deri më 20 Shkurt.

#### **Neni 21**

*MASH miraton deri më datë 1 Prill:*

- 21.1 Formularin A<sub>2</sub> (të dhënat e nxënësve që kanë marrë provimet e detyruara, me notën mesatare dhe përzgjedhjen e degëve të shkollave të larta ku dëshiron të studiojë).
- 21.2 Udhëzuesin e formularit A<sub>2</sub>.

Kandidatët që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në shkollat e larta duhet të plotësojnë edhe formularin A<sub>2</sub>, brenda datës 30 Qershor dhe ta dorëzojnë atë në KSHMSH.

#### **Neni 22**

Çdo nxënës në vitin e fundit të shkollës së mesme, pavarësisht nëse jep apo jo provimin me zgjedhje, plotëson dhe dorëzon formularin A<sub>1</sub> në KSHMSH-në e shkollës ku ai mëson, brenda datës 10 Mars.

Formularët e plotësuar dërgohen zyrtarisht nga KSHMSH e shkollës në KMSH-në e DAR-it dhe ZA-së brenda datës 25 Mars, së bashku me fotokopjen e tabelës së regjistrimeve dhe me tabelën e plotësuar përmbledhëse të të dhënave të formularëve.

KMSH-të e DAR-ve dhe ZA-ve hartojnë mbi këtë bazë listat e plota me të dhënat e të gjithë kandidatëve, sipas modelit të dërguar nga AVA dhe i dërgojnë ato zyrtarisht dhe në formë elektronike, të ndara sipas shkollave, së bashku me formularët e plotësuar, në AVA, brenda datës 31 Mars.

### Neni 23

Të gjithë personat që kanë kryer shkollat e mesme para vitit shkollor 2005-2006, kanë marrë Dëftesë Pjekurie dhe dëshirojnë të vazhdojnë studimet në shkollat e larta, do të japin dy provimet me zgjedhje.

*Regjistrimi për provimet me zgjedhje do të bëhet:*

- a) Në shkollat ku këta persona kanë kryer shkollat e mesme.
- b) Në KMSH të DAR-it apo ZA-së, ku ka figuruar shkolla e mesme, nëse shkolla e mesme apo profili i shkollës së mesme që kanë kryer është mbyllur. Në këtë rast, këta persona paraqesin në këtë KMSH dokumentet e mëposhtme:
  - 1 Vërtetimin që ka mbaruar shkollën e mesme, i shoqëruar me notat e 4 (katër) ose 5 (pesë) viteve të shkollës së mesme, lëshuar nga drejtori i shkollës përkatëse, bazuar në regjistrin themelor (amza).
  - 2 Kopje të noterizuara të dëftesës së pjekurisë.
  - 3 Një kopje të dokumentit të identifikimit të noterizuara, (pasaportë) ose certifikatë lindjeje me fotografi, lëshuar jo më vonë se tre muajt e fundit.
  - 4 Kërkesën me shkrim për dhënien e provimit me zgjedhje.

KMSH i DAR-it apo ZA-së cakton shkollën e mesme ku këta persona do të plotësojnë formularët  $A_1$  dhe  $A_2$  dhe do të japin provimet me zgjedhje. KMSH i DAR-it apo ZA-së përcakton për këta nxënës, në bazë të dokumenteve të paraqitura, notën mesatare të viteve të shkollimit si edhe notat e provimeve të detyruara  $D_1$  e  $D_2$  dhe ia përcjell ato zyrtarisht shkollës ku i cakton.

### Neni 24

Çdo nxënës që ka mbaruar shkollën e mesme para vitit shkollor 2005-2006, por NUK ka marrë dëftesën e pjekurisë, jep provime të detyruara dhe me zgjedhje. Ai plotëson dhe dorëzon Formularin  $A_1$  në shkollën ku e cakton KMSH i DAR-it dhe ZA-së përkatëse, pasi ka paraqitur tek ato dokumentet e mëposhtme:

1. Vërtetimin që ka mbaruar shkollën e mesme, të shoqëruar me notat e 4 (katër) ose 5 (pesë) viteve të shkollës së mesme, lëshuar nga drejtori i shkollës përkatëse, bazuar në regjistrin themelor (amza).
2. Një kopje të dokumentit të identifikimit të noterizuar, (pasaportë) ose certifikatë lindjeje me fotografi, lëshuar jo më vonë se tre muajt e fundit.

### 3. Kërkesën me shkrim për dhënien e provimeve.

#### Neni 25

Të gjithë nxënësit që në vitet shkollore 2005-2006 dhe 2006-2007 dhanë vetëm provimet e detyruara, por jo provimet me zgjedhje të Maturës Shtetërore, për t'u regjistruar në degët e shkollave të larta publike këtë vit duhet të japin provimet me zgjedhje, pranë shkollave të mesme ku kanë dhënë provimet e detyruara. Për këtë ata duhet të bëjnë kërkesë pranë KMSH të DAR/ZA përkatëse, duke paraqitur Dëftesën origjinale të Pjekurisë.

#### Neni 26

Të gjithë nxënësit që në vitet shkollore (2005-2006) dhe (2006-2007) dhanë provimet me zgjedhje të Maturës Shtetërore dhe nuk janë regjistruar në asnjë nga degët e shkollave të larta publike, për t'u regjistruar në këto shkolla këtë vit duhet të rijapin provimet me zgjedhje, pranë shkollave të mesme ku kanë dhënë provimet e detyruara. Për këtë ata duhet të bëjnë kërkesë pranë KMSH të DAR/ZA përkatëse, duke paraqitur Dëftesën origjinale të Pjekurisë.

#### Neni 27

KMSH-ja e DAR-it dhe ZA-së, pas verifikimit të dokumentacionit dhe kërkesës së çdo nxënësi/kandidati, të parashikuara në Nenet 23, 24, 25, 26 cakton shkollën ku nxënësi/kandidati regjistrohet për provimet e Maturës dhe e informon atë me shkrim.

KMSH-ja e DAR-it dhe ZA-së dërgon në KSHMSH dokumentacionin e çdo nxënësi/kandidati, të parashikuara në Nenet 23, 24, 25, 26.

KSHMSH-ja pas marrjes së njoftimit zyrtar dhe dokumentacionit përkatës, merr masa për regjistrimin e çdo nxënësi/kandidati, të parashikuara në Nenet 23, 24, 25, 26.

#### Neni 28

Çdo kandidat, i parashikuar në Nenet 22, 23, 24, 25, 26, që jep provimin me zgjedhje, paguan tarifën e Maturës Shtetërore, në mënyrë individuale, sipas udhëzimit të posaçëm që dërgon MASH. Pagesa kryhet para se të dorëzohet i plotësuar formulari A<sub>2</sub>.

#### Neni 29

Regjistrimi i çdo kandidati për provimin me zgjedhje, parashikuar në nenet 23, 24, 25, 26, 27, konsiderohet i plotë, në qoftë se krahas plotësimit me saktësi të çdo të dhëne të kërkuar, formularit A<sub>2</sub> i bashkëngjitet Mandat-arkëtimi original që

vërtetohet pagesën e tarifës së Maturës Shtetërore. Formulari A<sub>2</sub> pranohet vetëm i shoqëruar me Mandat-Arkëtimin

#### Neni 30

Në qoftë se për arsye të ndryshme kandidati **NUK** merr pjesë në provimin me zgjedhje për të cilin ka bërë pagesën, kjo e fundit **NUK** kthehet.

#### Neni 31

Formularët A<sub>1</sub>, A<sub>2</sub> dhe tabela përmbledhëse T konsiderohen të plotësuar, kur në to janë hedhur të gjitha të dhënat që duhet të plotësojë nxënësi dhe shkolla. Pas plotësimit secilit formular i bëhet një fotokopje që mbahet e protokolluar në drejtorinë e shkollës.

#### Neni 32

KSHMSH-ja, dërgon zyrtarisht në KMSH-në e DAR-it dhe ZA-së formularët A<sub>2</sub>, të plotësuar sipas Nenit 29, si edhe Tabelën e regjistrimeve, brenda datës 2 Korrik. KMSH-ja e DAR-it dhe ZA-së, pasi bën verifikimet përkatëse, i dërgon formularët, të ndarë sipas shkollave, së bashku me Tabelat e regjistrimeve, zyrtarisht me shkresë përcjellëse në MASH, më 11 Korrik.

#### Neni 33

33.1. Nxënësit shqiptarë që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë shtetit, kanë të drejtë të vazhdojnë studimet e larta në Republikën e Shqipërisë .

Nxënësit që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë shtetit dhe që nuk kanë dhënë provimet ekuivalente me Maturën Shtetërore (provimet me detyrim D<sub>1</sub> dhe D<sub>2</sub> dhe ato me zgjedhje Z<sub>1</sub> dhe Z<sub>2</sub>), për t'u pranuar në shkollat e larta publike duhet të japin provimet me zgjedhje.

33.2. Me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, pranë MASH ngrihet një Komision i Posaçëm për të shqyrtuar kërkesat e kësaj kategorie.

33.3. Nxënësit e përmendur në Pikën 1 të këtij Udhëzimi, paraqesin pranë këtij Komisioni këto dokumente:

1. Kërkesën me shkrim për të vazhduar shkollën e lartë publike.
2. Dëftesën origjinale me notat e mbarimit të shkollës së mesme, të përkthyer dhe të noterizuara.
3. Pasaportë ose Certifikatë lindjeje me fotografi.
4. Paraqitja e dokumenteve bëhet nga data 1 deri më 15 Prill 2008.

33.4. Komisioni, pasi njih vlefshmërinë e dëftesës shkollore, përcakton mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nëse provimet e dhëna që figurojnë në këtë dëftesë janë ekuivalente me Maturën Shtetërore.

33.5. Për nxënësit e përmendur në Pikën 1, për të cilët Komisioni vlerëson se dokumentet shkollore të tyre nuk dëshmojnë për dhënien e provimeve ekuivalente me Maturën Shtetërore, ky komision përlogarit notën mesatare të viteve të shkollimit dhe notat e provimeve të detyruara  $D_1$  dhe  $D_2$ . Këto nota Komisioni ia përcjell zyrtarisht KMSH-së DAR/ZA-ve, ku nxënësi ka vendbanimin, deri në datën 30 Prill 2007. KMSH e DAR/ZA-ve cakton shkollën ku kandidati do të kryejë provimet me zgjedhje dhe ku do të plotësojë formularët  $A_1$  dhe  $A_2$ , duke i përcjellë kësaj shkolle dhe notat që ka përcaktuar Komisioni i Posaçëm.

33.6. Formularët  $A_1$  të plotësuar nga nxënësit për të cilët bën fjalë ky nen dorëzohen zyrtarisht si edhe në formë elektronike në AVA, së bashku me përmbledhësen e të dhënave të nxënësve, brenda datës 5 Maj.

#### Neni 34

Formularët  $A_1$  të dorëzuar në AVA, së bashku me tabelat përmbledhëse të të dhënave, përpunohen nga AVA, e cila ndërton Bazën e të dhënave të çdo nxënësi/kandidati dhe pajis çdo nxënës/kandidat me një Numër regjistrimi përkatës, i cili përbën elementin kryesor të identifikimit të nxënësit/kandidatit.

AVA dërgon zyrtarisht, deri më 25 Maj, në KMSH-në e DAR-it dhe ZA-së, njoftimin ku jepet numri i regjistrimit të çdo nxënësi/kandidati për provimet e Maturës Shtetërore.

KMSH-ja e DAR-it dhe ZA-së i dërgon njoftimet me numrat e regjistrimit të çdo nxënësi/kandidati në KSHMSH brenda datës 30 Maj.

#### Neni 35

KSHMSH, 1 (një) ditë pas përfundimit të vitit shkollor, njofton çdo nxënës për numrin e regjistrimit.

KSHMSH-ja evidenton nxënësit mbetës dhe njofton zyrtarisht KMSH-në e DAR-it dhe ZA-së për nxënësit mbetës, 1 (një) ditë pas përfundimit të vitit shkollor

KMSH-ja e DAR-it dhe ZA-së, 2 (dy) ditë pas përfundimit të vitit shkollor, njofton zyrtarisht AVA-në për çdo nxënës mbetës, duke dërguar edhe në formë elektronike listën e nxënësve mbetës sipas shkollave.

#### Neni 36

AVA, bazuar në Nenin 35, ndërton Bazën e të dhënave përfundimtare dhe listën emërore përkatëse të nxënësve/kandidatëve që marrin pjesë në provimet e Maturës Shtetërore.

### **IV. PËRZGJEDHJA E MJEDISEVE TË ZHVILLIMIT TË PROVIMEVE TË MATURËS SHETËRORE**

#### Neni 37

KMSH-ja e DAR-it dhe ZA-së evidenton dhe inspekton mjediset ku zhvillohen provimet e Maturës, 2 (dy) muaj para kryerjes së tyre.

#### Neni 38

*Konsiderohen mjedise të përshtatshme për zhvillimin e provimeve të Maturës, ato që plotësojnë kriteret e mëposhtme:*

- 38.1. Mjedisi më i vogël i përshtatshëm për zhvillimin e provimeve të jetë i mjaftueshëm për të paktën 15 nxënës.
- 38.2. Largësia ndërmjet çdo nxënësi/kandidati të jetë jo më pak se 120 cm larg nga njeri nxënës/kandidat tek tjetri, si majtas-djathtas, ashtu dhe para-prapa.
- 38.3. Në ditën e provimit **NUK** zhvillohen aktivitete të tjera që ndërpresin provimin.
- 38.4. Mjediset të jenë të ajrosura dhe të ndriçuara.
- 38.5. Në mjediset ku zhvillohet provimi **NUK** ka postera, tabela ose materiale të tjera që kanë lidhje me lëndën që jepet provim.
- 38.6. Nxënësit/kandidatët ulen me fytyrë në të njëjtin drejtim.
- 38.7. Sipërfaqja që nxënësi/kandidati ka në dispozicion për të shkruar është të paktën (40 x 60) cm.
- 38.8. Çdo mjedis që përzgjidhet për zhvillimin e provimeve, të ketë komunikim me rrugë automobilistike.

#### Neni 39

Për provimet e Maturës, në shkollat ku numri i nxënësve/kandidatëve është më i vogël ose e barabartë me 20 (njëzetë), KMSH-ja e DAR-it dhe ZA-së grupon shkollat dhe cakton mjedisin ku zhvillohen provimet.

KMSH-ja njofton KSHMSH-të përkatëse për të lajmëruar çdo nxënës/kandidat me shkrim dhe për t'u krijuar atyre kushte lehtësuese transporti për provimet e detyruara.

Nxënësit e shkollave jopublike do t'i zhvillojnë provimet e maturës shtetërore në mjediset e shkollave publike.

#### Neni 40

KMSH-ja e DAR-it dhe e ZA-së merr masa që provimet me zgjedhje të zhvillohen VETËM në qytetet e DAR-it dhe ZA-së, mundësisht në mjedise të mëdha dhe që plotësojnë kriteret e përcaktuara në Nenin 38.

#### Neni 41

KMSH-ja e DAR-it dhe ZA-së pas përcaktimit të mjediseve ku zhvillohen provimet e Maturës, dërgon në MASH, AVA dhe në KSHMSH, deri më 10 Maj listën e mjediseve përkatëse.

KSHMSH-ja, pas marrjes së njoftimit nga KMSH e DAR-it dhe ZA-së merr masat e nevojshme për organizimin dhe rregullimin e çdo mjedisi.

KSHMSH-ja, njofton çdo nxënës/kandidat, për mjedisin ku ai jep provimet e Maturës

### **V. PROCEDURAT E SHPËRNDARJES DHE GRUMBULLIMIT TË MATERIALEVE TË PROVIMEVE TË MATURËS**

#### Neni 42

Shpërndarja dhe grumbullimi i materialeve të provimeve bëhet me Procesverbal. Materialet e provimit tërhiqen në AVA nga dy persona: përfaqësuesi i autorizuar me shkrim nga kryetari i KMSH, të DAR dhe ZA dhe një person i autorizuar nga MASH, sipas grafikut të shpërndarjes të dërguar nga MASH. Personat e autorizuar sipas këtij neni mbajnë përgjegjësi për ruajtjen e sekretit dhe sigurimin e tyre deri në dorëzimin tek kryetari i KMSH-së së DAR-it dhe ZA-së.

#### Neni 43

Kryetari i KMSH-së së DAR-it dhe ZA-së, pas marrjes në dorëzim të materialeve të provimit, i ruan ato në kasafortë dhe mban përgjegjësi ligjore, individuale, institucionale, sipas dispozitave ligjore në fuqi për ruajtjen e sekretit dhe sigurimin e tyre.

#### Neni 44

Materialet e provimit tërhiqen me procesverbal në KMSH-në e DAR-it dhe ZA-së nga Përgjegjësi i Administrimit të Provimit

(PAP), në prani të përfaqësuesit të KMSH-së së DAR-it dhe ZA-së që do ta shoqërojë atë, në mëngjesin e ditës së provimit, 2 (dy) orë para fillimit të provimit.

Këta dy persona mbajnë përgjegjësi ligjore, individuale, sipas dispozitave ligjore në fuqi, për ruajtjen e sekretit dhe sigurimin deri në momentin e hapjes së tyre. Kutia me materialet e provimit është përgjegjësi e PAP.

Në zonat rurale koha e shpërndarjes së materialeve të provimit është në varësi të largësisë së mjedisit të provimit nga DAR-i dhe ZA-ja.

#### Neni 45

45.1. Pas shpërndarjes se testeve nga PAP për çdo administrator provimi (AP), testet e ngelura (të papërdorura) PAP i fut në zarf dhe i mbyll. Këto teste qëndrojnë në kasafortën e drejtorisë së shkollës (ose në ndonjë vend tjetër të sigurt) deri në përfundim të provimit.

45.2. Pas përfundimit të provimit, administratori i provimit i dorëzon me Procesverbal përgjegjësit të administrimit të provimit Test-broshurat e plotësuara nga çdo nxënës/kandidat. Përgjegjësi i administrimit të provimit Test-broshurat e grumbulluara, Testet e papërdorura dhe materialet e tjera të provimit i mbyll në kuti në kushtet e sigurisë në prani të përfaqësuesit të KMSH-së së DAR-it dhe ZA-së, dhe administratorit të provimit.

45.3. Kutia e mbyllur vulloset nga drejtori i shkollës përkatëse. Në rast të grupimit në një mjedis të nxënësve nga shkolla të ndryshme, përdoret vula e shkollës pritëse.

45.4. Përfaqësuesi i KMSH-së i DAR-it dhe ZA-së dhe përgjegjësi i administrimit të provimit, dorëzojnë në KMSH-në e DAR-it dhe ZA-së me Procesverbal kutinë me materialet e provimit.

45.5. Personi i autorizuar nga MASH, ngarkohet edhe me detyra të tjera si koordinator dhe mbështetës i KMSH së DAR dhe ZA, për zhvillimin normal të provimeve të Maturës Shtetërore.

#### Neni 46

Ditën e provimit, pas përfundimit të provimit, përfaqësuesi i autorizuar me shkrim nga kryetari i KMSH të DAR/ ZA dhe personi i autorizuar nga MASH, kutitë e dorëzuara sipas Nenit 45, si dhe materiale të tjera të provimit, i sjellin në AVA.

## **VI. PROCEDURA E SHPËRNDARJES SË PËRGJEGJËSIT TË ADMINISTRIMIT, ADMINISTRATORËVE TË PROVIMIT DHE TË SEKRETIMIT NË MJEDISËT E PROVIMEVE TË MATURËS**

### Neni 47

47.1. Për mjediset/sallat me mbi 15 nxënës caktohet një administrator provimi për çdo 20-25 nxënës.

47.2. Çdo KMSH e DAR-it dhe ZA-së, pasi merr informacion nga KSHMSH-ja për numrin e nevojshëm të administratorëve të provimeve dhe sekretimit, bën hartën e shpërndarjes së tyre në mjediset/sallat e provimit.

47.3. KMSH e DAR-it dhe ZA-së harton listën emërore për çdo provim të Maturës, të individëve sipas rendit alfabetik, që do të jenë përgjegjës të administrimit, administratorë provimi dhe njëkohësisht listën emërore të administratorëve të sekretimit.

47.4. KMSH e DAR/ZA për mjediset e mëdha e me disa kate mund të zgjedhë edhe nga një administrator kati (palestre), me qëllim që këta të asistojnë PAP në administrimin e provimit.

47.5. KMSH-ja e DAR-it dhe ZA-së organizon shortin për shpërndarjen sipas mjedisëve të përgjegjësve të administrimit, administratorëve të provimit dhe sekretimit, në ditën e provimit të Maturës, 3 (tre) orë para fillimit të tij.

47.6. KMSH-ja e DAR-it dhe ZA-së vendos me short emrat e mjedisëve ku do të zhvillohen provimet.

47.7. Pasi përzgjidhet mjedisi i provimeve, në përputhje me numrin e administratorëve të provimeve dhe sekretimit për këtë mjedis, vendoset vija ndarëse sipas rendit zbritës, në listat emërore të shpallura të përgjegjësve të administrimit të provimit, administratorëve të provimit dhe të sekretimit.

47.8. Në DAR-të dhe ZA-të ku provimet zhvillohen vetëm në një mjedis, përzgjedhja respekton kërkesat e nenit 50.

## **VII. ADMINISTRIMI I PROVIMIT**

### Neni 48

#### ***Detyrat e Përgjegjësit të Administrimit të Provimit (PAP)***

*Gjatë dhe pas zhvillimit të provimeve PAP ka këto detyra:*

48.1. Tërheq në DAR-në ose ZA-në, materialet e provimit;

- 48.2. Udhëzon dhe shpërndan administratorët e provimeve;
- 48.3. Bën identifikimin e nxënësve/kandidatëve përpara hyrjes në provim sipas listës emërore të dërguar nga AVA;
- 48.4. Shpërndan materialet e provimeve administratorëve të provimeve të Maturës dhe i hap ato në prani të nxënësve/kandidatëve;
- 48.5. Respekton orarin e zhvillimit të provimeve;
- 48.6. Nuk lejon hyrjen e personave të paautorizuar në mjediset e provimit;
- 48.7. Njofton dhe raporton tek KMSH-ja pranë DAR-it dhe ZA-së për çdo rast parregullsie gjatë zhvillimit të provimit;
- 48.8. Dokumenton çdo parregullsi dhe masë që merr dhe ia dorëzon ato KMSH-së pranë DAR-it dhe ZA-së;
- 48.9. Bën paketimin e Test-broshurave të papërdorura, pas shpërndarjes së test-broshurave çdo nxënësi/kandidati në mjedisin e provimit;
- 48.10. Bën paketimin e Test-broshurave të përdorura dhe materialeve të tjera të provimit, pas përfundimit të provimit;
- 48.11. Plotëson formularin e zhvillimit të provimit të dërguar nga AVA;
- 48.12. Kryen dorëzimin e materialeve të provimit në KMSH-në e DAR-it dhe ZA-së, pas përfundimit të provimit.

#### Neni 49

#### ***Detyrat e Administratorit të Provimit (AP)***

*Gjatë ditës së provimit administratori i provimit kryen detyrat e mëposhtme:*

- 49.1 Bën identifikimin e çdo nxënësi/kandidati përpara hyrjes së tij në provim, sipas listës së dërguar nga AVA, në qoftë se i kërkohet nga PAP;
- 49.2 I shpërndan dhe i grumbullon çdo nxënësi/kandidati materialet e provimit;
- 49.3 Njih çdo nxënës/kandidat me rregullat e provimit dhe masat që merren ndaj atyre që nuk i zbatojnë ato;
- 49.4 Mbikëqyr gjatë gjithë kohës procesin e provimit;
- 49.5 Respekton orarin e zhvillimit të provimit;

- 49.6 Nuk lejon hyrjen e personave të paaautorizuar në mjediset e provimit që i janë caktuar për të mbikëqyrur;
- 49.7 Njofton dhe raporton tek përgjegjësi i administrimit të provimit për çdo rast parregullsie gjatë zhvillimit të provimit;
- 49.8 Dokumenton çdo parregullsi si dhe masat që merren dhe ia dorëzon ato PAP;
- 49.9 Lajmëron nxënësit 30 minuta përpara mbarimit të kohës së zhvillimit të provimit.

#### Neni 50

#### **Rregulla për Administratorin e Provimit (AP)**

*Administratori i provimit që caktohet për mbikëqyrjen e nxënësve/kandidatëve nuk është mësues i asaj shkolle dhe i lëndës që po merret në provim.*

*Gjatë provimit ai zbaton rregullat e mëposhtme:*

- 50.1. Ndalohet të mbajë celular gjatë zhvillimit të provimit;
- 50.2. Drejton çdo nxënës/kandidat nëpër vende dhe nuk lejon ndërrimin e vendeve;
- 50.3. Nuk lejon asgjë tjetër, përveç stilolapsit dhe certifikatës personale në tavolinën e çdo nxënësi/kandidat;
- 50.4. Sigurohet që çdo nxënës/kandidat e ka kuptuar se çfarë duhet të bëjë;
- 50.5. Gjatë kohës së provimit, zë një pozicion që të mbikëqyrë të gjithë mjedisin e provimit;
- 50.6. Nuk largohet për asnjë moment nga mjedisi i provimit;
- 50.7. Nuk lejon ngrënien, zhurmën, kopjen ose komunikimin e nxënësve/ kandidatëve me njëri-tjetrin;
- 50.8. Vendos çdo nxënës/kandidat në mënyrë të atillë që çdonjëri të shikojë në të njëjtin drejtim;
- 50.9. Nuk i përgjigjet asnjë pyetjeje të nxënësit/kandidatit mbi përmbajtjen e testit;
- 50.10. Nuk lejon për asnjë arsye largimin e nxënësit/kandidatit nga mjedisi i provimit pa realizimin e procesit të sekretimit;
- 50.11. Kontrollon gjatë marrjes në dorëzim të testit mos dëmtimin e Barkodit nga ana e nxënësit/kandidatit;
- 50.12. Vendos në dosjen e caktuar materialet e provimit që dorëzohen nga nxënësit/kandidatët;

- 50.13. Ndalohet të shfletojë ose të bëjë shënime në materialet e provimit, si gjatë tij edhe pas tij;
- 50.14. Nuk lejon ASNJË nxënës/kandidat të ketë kohë shtesë për zhvillimin e provimit;
- 50.15. Nuk lejon asnjë individ tjetër të paautorizuar në mjedisin e provimit.

#### Neni 51

### ***Administratorët e Sekretimit (AS)***

- 51.1. Për kryerjen e procesit të sekretimit në mjediset e provimit që kanë mbi 60 nxënës/kandidatë, caktohen administratorë të sekretimit. Këta administratorë caktohen nga KMSH-ja e DAR-it dhe ZA-së. Për çdo 60-70 nxënës/kandidatë ka nga një administrator sekretimi.
- 51.2. Administratorët e sekretimit kryejnë vetëm procesin e sekretimit
- 51.3. AVA, mbështetur në numrin e nxënësve/kandidatëve të regjistruar, përgatit listën emërore të nxënësve/kandidatëve dhe Barkodet përkatëse.
- 51.4. AVA përgatit udhëzimet për përgjegjësit e administrimit të provimit dhe administratorëve që merren me sekretimin, për vendosjen e Barkodeve në Test-broshurën e nxënësit/kandidatit dhe në listën emërore

#### Neni 52

### ***Hyrja e nxënësve/kandidatëve në mjediset e provimit***

- 52.1. Nxënësi/kandidati paraqitet në shkollë 1 (një) orë përpara fillimit të provimit. Në këtë kohë kryhet identifikimi i nxënësit/kandidatit, hyrja në mjediset e provimit (klasa), ulja e tyre në vende si dhe leximi i rregullave për nxënësit/kandidatët.
- 52.2. Procesi i identifikimit të çdo nxënësi/kandidati gjatë hyrjes së tyre në mjediset e provimit kryhet nga përgjegjësi i administrimit të provimit. Me kërkesën e tij, ai mund të ndihmohet nga drejtori i shkollës dhe administratorët e provimit.
- 52.3. Pas fillimit të zhvillimit të provimit, drejtori i shkollës NUK lejohet të hyjë në mjediset ku zhvillohet provimi.

- 52.4. Hyrja dhe ndarja e çdo nxënësi/kandidati nëpër klasa, bëhet duke ndjekur RIGOROZISHT rendin zbritës të listës emërore të dërguar nga AVA.
- 52.5. Nxënësi/kandidati, ditën e provimit, ka me vete për identifikim certifikatën personale me fotografi ose letërnjoftim.
- 52.6. Lejohet hyrja në provim vetëm e nxënësit/kandidatit të shpallur në listë.
- 52.7 Sistemimi i çdo nxënësi/kandidati, në mjediset/sallat e provimit bëhet një nga një, sipas rendit të hyrjes së tyre. NDALOHET ndërrimi i vendeve.
- 52.8 Në ato shkolla apo mjedise ku provimi administrohet vetëm në një klasë, sistemimi i nxënësve bëhet sipas rendit alfabetik.

### Neni 53

#### ***Procedura e sekretimit të testit***

- 53.1. Sekretimi i testeve fillon menjëherë, pasi ka filluar procesi i zhvillimit të provimit.
- 53.2. Procesi i sekretimit të testeve realizohet nga administratori i sekretimit dhe përgjegjësi i administrimit të provimit.
- 53.3. Administratori i sekretimit, pasi kryen identifikimin e nxënësit /kandidatit dhe prezencën e tij në listën emërore, realizon ngjitjen e etiketave të kodit të sekretimit në hapësirat e parashikuara në test dhe në listën emërore. Gjatë procesit të sekretimit nxënësi të firmosë pasi të ketë verifikuar ngjitjen e Barkodeve në listën emërore dhe në testin e tij.
- 53.4. Administratori i sekretimit ngjit njëherë nga etiketat e kodit të sekretimit mbi vendin e parashikuar në test dhe etiketën tjetër, të çiftit të kodit të sekretimit, e ngjit përkrah emrit të nxënësit/kandidatit në listën emërore.
- 53.5. Përgjegjësi i administrimit të provimit së bashku me administratorët e sekretimit bëjnë mbylljen e kodeve të sekretimit të përdorura, pas përfundimit të procesit të sekretimit.

### Neni 54

## ***Përrjashtimi ose mosnjohja e rezultateve të provimit të nxënësi/kandidatit***

*Ditën e provimit nxënësi/kandidati përjashtohet ose nuk i njihet rezultati i provimit në qoftë se:*

- 54.1. Nuk është i pajisur me dokument identifikimi si certifikata personale me fotografi;
- 54.2. Nuk qëndron në vendin që i caktohet;
- 54.3. Përpiqet të japë provimin për një nxënës/kandidat tjetër;
- 54.4. Bën përpjekje të fitojë në mënyrë të padrejtë informacion mbi përmbajtjen e testit;
- 54.5. Merr ose jep ndihmë, informacion, kopje ose komunikon me nxënës /kandidatë të tjerë;
- 54.6. Bën komente lidhur me përmbajtjen ose zgjidhjen e testit gjatë kohës së zhvillimit të provimit;
- 54.7. Përdor mjete shkrimi të ndryshme nga ato të specifikuara për këtë qëllim (të cilat janë: stilolaps me ngjyrë të zezë ose blu dhe vizore, laps, gomë- vetëm për provimin e matematikës);
- 54.8. Merr me vete telefon celular, radio ose çdo mjet tjetër komunikimi në mjedisin e provimeve;
- 54.9. Largohet nga mjedisi i provimit pa kryer procesin e sekretimit;
- 54.10. Shkruan ose dëmton kodin e sekretimit (Barkodin) të vendosur në test.

### Neni 55

#### ***Penalizimet e nxënësve/kandidatëve***

*Në qoftë se një nxënës/kandidat thyen rregullat e provimit, atëherë administratori i provimit njofton përgjegjësin e administrimit të provimit dhe merr këto masa disiplinore:*

- 55.1. Nxënësi/kandidati përjashtohet nga provimi, në qoftë se thyen rregullat e provimit;
- 55.2. Nxënësi/kandidati përjashtohet nga provimi dhe i hiqet e drejta të japë provimet e Maturës për vitin në vazhdim, në qoftë se nuk zbaton rregullat e Pikave 54.3, 54.4, 54.5 dhe 54.8.

Në qoftë se përgjegjësi i administrimit të provimit merr një nga masat e parashtruara në Pikën 55.1 ose 55.2, ai urdhëron

nxënësin/kandidatin të largohet nga salla e provimit, pa shqetësuar të tjerët.

Në rast se nxënësi/kandidati refuzon të largohet nga mjedisi i provimit, përgjegjësi i administrimit të provimit e informon atë mbi mosnjohjen e rezultatit dhe lejon vazhdimësinë e provimit.

#### Neni 56

#### ***Të drejtat e nxënësve/kandidatëve***

- 56.1. Në rast se nxënësi/kandidati vëren ndonjë shkelje të rregullores së provimit nga ana e nxënësve të tjerë, ai ka të drejtë të raportojë për parregullsi tek administratori i provimit.
- 56.2. Nxënësve maturantë të verbër, pasi u jepet broshura e testit, të veçohen në një mjedis të përshtatshëm e të ndihmohen, duke caktuar një person të besueshëm, për leximin e pyetjeve të testit dhe për plotësimin e përgjigjeve, që jep me gojë nxënësi, në fletën e testit. Në këto raste të mundësohet regjistrimi i përgjigjeve.
- 56.3. Maturantët që dorëzojnë testin e provimit përpara kohës së përcaktuar, nuk duhet të dalin nga mjedisi ku zhvillohet provimi para dy orësh nga fillimi i tij, por të grumbullohen në një sallë, të përcaktuar që më parë.

### **VIII. PROCEDURA E VLERËSIMIT TË TESTEVE**

#### Neni 57

- 57.1. Vlerësimi i përgjigjeve të nxënësve/kandidatëve në provimet e detyruara dhe me zgjedhje bëhet me pikë të cilat ekuivalentohen në notë.
- 57.2. Vlerësimi i çdo përgjigjeje të dhënë nga nxënësi/kandidati për kërkesën përkatëse, mbështetet në skemën e vlerësimit të përgatitur nga hartuesit e testeve.
- 57.3. Skema e vlerësimit është një standard vlerësues i njëjtë për çdo nxënës/kandidat. Çdo përgjigje e plotë, e saktë ose e pjesshme e dhënë nga nxënësi/kandidati për çdo kërkesë, vlerësohet me pikë, sipas skemës së vlerësimit.
- 57.4. Nxënësi/kandidati vlerësohet me 0 (zero) pikë, kur jep përgjigje të gabuar ose nuk jep asnjë përgjigje.
- 57.5. Pas përfundimit të çdo provimi të Maturës, AVA shpall skemën e vlerësimit të testit.

- 57.6. Vlerësues të jashtëm vlerësojnë testet e provimit të Maturës.
- 57.7. Vlerësues i jashtëm për provimet e Maturës është çdo mësues i shkollës së mesme, pedagog ose specialist me përvojë në mësimdhënie në lëndën që zhvillohet provimi.
- 57.8. Drejtori i AVA-s, emëron vlerësuesit e jashtëm dhe kryetarët e tyre.
- 57.9. Zgjedhja e vlerësuesve të testeve kryhet çdo vit. Numri i tyre është në varësi të numrit të testeve që vlerësojnë dhe kohës së shpalljes së rezultateve të vlerësimit.
- 57.10. Çdo vlerësues firmos në çdo test që vlerëson.
- 57.11. Para fillimit të procesit të vlerësimit të testeve, grupi i hartimit të testeve të AVA trajnon vlerësuesit e testeve.
- 57.12. Vlerësimi i testeve realizohet në mjediset që përzgjidhen nga AVA dhe miratohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në kushte të përshtatshme dhe të sigurta.
- 57.13. Çdo test vlerësohet nga dy vlerësues.
- 57.14. Kur midis dy vlerësuesve ka ndryshime pikësh për të njëjtat kërkesa, kryetari i vlerësuesve të lëndës cakton një vlerësues të tretë, vendimi i të cilit është përfundimtar.
- 57.15. MASH-i, ngre grupe monitoruesish të vlerësimit të testeve sipas lëndëve, të cilët në mënyrë të rastësishme monitorojnë testet e vlerësuara. Këta grupe gjithashtu shqyrtojnë rast për rast të gjithë testet që raportohen si të dyshimta për kopjim nga vlerësuesit e testeve.
- 57.16. MASH, ngre komisione të posaçme (KOPOTED), që shqyrtojnë rast për rast të gjithë testet që raportohen si të dyshimta për kopjim nga vlerësuesit e testeve.
- 57.17. Për të gjitha parregullsitë që konstatojnë, secili KOPOTED informon MASH-in, i cili merr vendimin përkatës.
- 57.18. Procesi i vlerësimit të testeve mbikëqyret nga përfaqësues të Komitetit të Maturës Shtetërore.
- 57.19. Shpallja e rezultateve bëhet jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, pas çdo provimi të Maturës.

## **IX. ZHVILLIMI I PROVIMEVE TË DETYRUARA TË MATURËS SHTETËRORE NË SESIONIN E DYTË**

### Neni 58

Çdo DAR dhe ZA të paraqesë në AVA deri në datën 30 gusht listën e nxënësve maturantë që do të marrin pjesë në provimet e detyruara në sesionin e dytë, duke specifikuar për secilin lëndën (lëndët) që do të japë provim sipas formularit A<sub>1</sub>. Lista dorëzohet me shkresë zyrtare dhe në formë elektronike. Bashkë me këtë listë dorëzohet në AVA edhe lista e mjediseve ku do të zhvillohen provimet.

Hartimi i testeve përfundimtare për provimet e detyruara të Maturës Shtetërore në sesionin e dytë bëhet nga persona të përcaktuar me urdhër të brendshëm të drejtorit të AVA-s. Në AVA bëhet shumëfishimi dhe paketimi i Test-broshurave.

Shpërndarja e dokumentacionit të përgatitur nga AVA për provimet e detyruara të Maturës Shtetërore në sesionin e dytë bëhet sipas grafikut të hartuar nga ky institucion.

Dokumentacioni i provimeve tërhiqet pranë AVA-s 1 (një) ditë para datës së zhvillimit të provimit nga përfaqësues të autorizuar prej drejtorit të DAR dhe ruhet në ambiente të sigurta. DAR tërheqin edhe dokumentacionin e ZA që kanë në vartësi.

Provimet zhvillohen në mënyrë të përqendruar në mjedise, të përcaktuar nga DAR/ZA duke zbatuar të njëjtat rregulla dhe procedura sipas “Rregullores së zhvillimit të Maturës Shtetërore”. Dorëzimi i dokumentacionit të provimit të bëhet menjëherë pas përfundimit të provimit, njëjloj me skemën e tërheqjes.

## **X. KLASIFIKIMI I MATERIALEVE DHE RUAJTJA E SEKRETIT**

### Neni 59

#### ***Konsiderohen materiale të “klasifikuar”:***

- 59.1. Fondi dhe banka e kërkesave të testeve;
- 59.2. Testet përfundimtare dhe skemat e vlerësimit të testeve përkatëse;
- 59.3. Kodet e sekretimit të prodhuara nga AVA;
- 59.4. Test-broshurat e plotësuara nga çdo nxënës/kandidat;
- 59.5. Pikët dhe notat përkatëse;

59.6. Baza e te dhënave te maturës shtetërore te AVA-s.

#### Neni 60

##### ***Në mjediset e AVA-së zbatohen rregullat e mëposhtme:***

- 60.1. Lejohet hyrja në mjediset e AVA-s, vetëm e personave të autorizuar;
- 60.2. Lejohet hyrja në mjedisin teknik vetëm e personave që kanë lidhje me procesin e punës;
- 60.3. Hyrja në mjediset e AVA-s bëhet në mënyrë elektronike të kontrolluar;
- 60.4. Mjedisi teknik vëzhgohet nga kamera;
- 60.5. Ndalohet qëndrimi vetëm i një individi në mjedisin teknik;
- 60.6. Ndalohet mbajtja e celularëve, mjeteve të tjera të komunikimit dhe gjithçka tjetër që cenon sigurinë e procesit në mjedisin teknik;
- 60.7. Bëhet kryerja e kontrollit fizik gjatë hyrjes dhe daljes së personave në mjedisin teknik.

#### Neni 61

##### ***Për sigurimin e kërkesave të testeve zbatohen këto rregulla:***

- 61.1 Nënshkrimi i kontratës individuale me çdo person që angazhohet në hartimin e fondit, bankës dhe kërkesave të testit përfundimtar;
- 61.2 Nënshkrimi i deklaratës nga punonjësit e AVA-s për konflikt interesi;
- 61.3 Ruajtja në kompjuter e materialeve të provimeve nga specialistët lëndorë, duke aplikuar elemente sigurie si fjalëkalime të shumëfishta, mungesë komunikimi elektronik dhe në rrjet;
- 61.4 Ruajtja në kasafortë e tri seteve të testeve dhe skemës së vlerësimit;
- 61.5 Paketimi me elemente sigurie i materialeve të provimit.

#### Neni 62

Personat fizikë e juridikë, të cilët janë në kontakt të drejtpërdrejtë me materialet e konsideruar të “Klasifikuar” sipas pikave të Nenit 59, janë të detyruar të veprojnë në përputhje me këtë Rregullore. Në rast shkeljeje, i kalohen organeve të drejtësisë për ndjekje penale.

## **XI. REGJISTRIMI DHE RUAJTJA E TË DHËNAVE**

### Neni 63

Për qëllime të mbikëqyrjes dhe të përmirësimit të provimit të Maturës, AVA mban të dhënat e çdo nxënësi/kandidati, të vlerësuesve të jashtëm dhe të mjediseve ku janë realizuar provimet e Maturës si dhe rezultatet e çdo nxënësi/kandidati në këto provime.

AVA mbledh, përpunon, ruan të dhënat personale dhe çdo shënim tjetër. Këto përdoren nga AVA për qëllime administrimi dhe analiza të provimeve të Maturës, nga MASH-i dhe institucione të tjera shtetërore, me autorizim të MASH.

Të dhënat personale të çdo nxënësi/kandidati dhe vlerësuesve të jashtëm janë konfidenciale.

Informacioni dhe renditja e shkollave sipas rezultateve të çdo nxënësi/kandidati është konfidencial.

## **XII. NJOHJA ME REZULTATET E POVIMEVE TË MATURËS SHTËTËRORE**

### Neni 64

Çdo pjesëmarrës në provimet e Maturës Shtetërore, pas shpalljes së rezultateve të provimit, ka të drejtë të kërkojë një kopje të testit që ai ka zhvilluar, me rezultatet përkatëse të vlerësimit. Për këtë, brenda 7 ditëve pas shpalljes së rezultateve të provimit, ai paraqet pranë KSHMSH-së një kërkesë duke paguar një tarifë prej 400 lekësh për çdo kopje të testi, në sekretarinë e shkollës.

KSHMSH, pasi grumbullon të gjitha kërkesat, i shqyrton ato rast pas rasti dhe i përcjell në KMSH pranë DAR/ZA-së, së bashku me një mandat-arkëtimi të përbashkët për të gjithë kërkuessit, për llogari të AVA-s. KMSH pranë DAR/ZA shqyrton kërkesat e paraqitura nga KSHMSH-të dhe i përcjell ato zyrtarisht tek AVA, shoqëruar me Mandat- arkëtimet përkatëse.

AVA, pasi merr kërkesat, dërgon në KMSH të DAR/ZA fotokopjet e testeve të kërkuessve. KMSH e DAR-it/ZA-s i përcjell këto fotokopje tek KSHMSH, i cili jep fotokopjen e tij kërkuessit. Çdo kërkuess firmos për tërheqjen e fotokopjes së testit.

Nisur nga procedurat e vlerësimit të testeve, vlerësimi i shpallur nga AVA, për çdo pjesëmarrës në provime, nuk do të rishikohet.

### **XIII. ARKIVIMI I DOKUMENTEVE TË PROVIMIT TË MATURËS**

#### Neni 65

Çdo dokument i provimit të kandidatit arkivohet si dokument sekret në arkivin e AVA-s deri më 31 dhjetor të vitit ku çdo kandidat i nënshtrohet provimeve të Maturës Shtetërore.

Pas datës 31 janar të vitit në vazhdim, AVA eliminon çdo Test-broshurë të çdo nxënësi/kandidati.

#### Neni 66

*Kjo rregullore zbatohet duke filluar nga viti shkollor 2007-2008.*

## **IV. MATERIALE PËR KËSHILLIMIN E KARRIERËS**

---

Nga vështirësitë e konstatuara gjatë zbatimit të maturës shtetërore në dy vitet e kaluara, lidhur me njohjen nga ana e nxënësve, mësuesve, prindërve të gjithë mekanizmit të maturës shtetërore, si dhe nga problemet e krijuara në plotësimin e Formularit A2 për përzgjedhjen e programeve të studimit për shkollën e lartë, në këtë kapitull të Guidës do të gjeni materiale që do t'ju ndihmojnë pikërisht për këtë proces, si më poshtë:

### **MATERIALET E KONFERENCËS PËR KËSHILLIMIN E KARRIERËS**

Fjala e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës **Z. Genc Pollo** dhe të Zv/Ministrit të Arsimit dhe Shkencës **Z. H. Shamata**, në Konferencën e mbajtur në Institucionin e Arsimit të Lartë, "Zonja e Këshillit të Mirë" organizuar për orientimin e të rinjve në zgjedhjen e studimeve universitare, apo i quajtur ndryshe Këshillimi i Karrierës për maturantët.

*“Mendoj që iniciativa e sotme për të diskutuar mbi Këshillimin e Karrierës në shkollë të mesme apo shkollë të lartë, orientimi i atyre që përfundojnë shkollën e mesme apo profesionale dhe drejtohen drejt universiteteve, është diçka shumë e rëndësishme, që ka munguar dhe që patjetër duhet të zhvillohet. Siç e dimë, qeveria jonë i ka kushtuar arsimit një rëndësi të jashtëzakonshme, duke e shpallur atë prioritet kryesor kombëtar duke qenë e ndërgjegjshme se me një arsim masiv dhe cilësor realizohet një shoqëri e nesërme më e avancuar, më e mirë, e aftë për të ecur përpara dhe për të konkurruar me hapa më të shpejta në tregjet globale. Kjo dëshirë e vullnet për të bërë arsimin prioritet tonin, është materializuar me nisma dhe reforma të shumta, me buxhetimin përkatës si dhe me përpjekje të vazhdueshme për të rritur numrin e studentëve në Arsimin e Lartë dhe për të ngritur standardet e institucioneve të Arsimit të Lartë në shifra që janë pothuaj të pa krahasueshme me ato të tre viteve më para. Megjithatë jemi të ndërgjegjshëm që asnjë zhvillim madhor në arsim nuk mund të kryhet në një cikël të vetëm dhe efektet mund të jepen pas shumë vitesh. Por gjithashtu jemi të ndërgjegjshëm që orientimet kryesore dhe reformat e*

*duhura që vihen në shinat e drejta do të jenë frytdhënëse edhe për vitet e mëvonshme edhe për këdo që do të administrojë arsimin.*

*Mendojmë që me përfundimin e shkollës së mesme përmes Maturës Shtetërore dhe sistemin e pranimeve në universitete përmes Meritë-Preferencës (MeP) kemi vendosur një taban të shëndoshë me nevojën për ti konsoliduar dhe zhvilluar më tej. Ajo që mungon në mozaikun tonë është një këshillim i duhur i karrierës. Këshillim për nxënësit e shkollave të mesme, gjimnazistët dhe nxënës të shkollave profesionale, duke u përqendruar te maturantët, të cilët zgjedhin shkollën e lartë, por jo duke u kufizuar te ata. Shkolla e mesme është një periudhë në jetën e njeriut, që shënohet nga pjekuria moshore nga nevoja për të marrë vendime të rëndësishme, vendime që kanë të bëjnë me të ardhmen, në kuadrin e kurrikulës së arsimit të mesëm, me përzgjedhjen e asaj që mund të jetë kurrikulë opsionale, por edhe me fillimin e gjetjes te vetvetja se çfarë do të bëhesh kur të rritesh, ashtu siç e kemi e pyetur të gjithë veten, çfarë do të bëhem kur të jem i madh?*

*Por nuk është thjesht çështje fantazie dhe dëshirash pa kriter, është një çështje realiteti, gjetjesh të prirjeve të brendshme, të aftësive shkollore, të rezultateve konkrete, në përputhje me mundësitë që ofrojnë institucionet e arsimit të lartë në vend, në mënyrë që gjithkush të shkojë aty ku dëshiron, aty ku ka të dhëna, ku ka mundësi, dhe aty ku e meriton. Ne i kemi kushtuar shumë rëndësi vitin e kaluar dhe një vit më parë informimit mbi maturën shtetërore, mbi mënyrën se si jepen provimet e detyruara, çfarë menyje kemi për të përcaktuar cilat do jenë provimet me zgjedhje për çdo maturant dhe për mënyrën se si kalkulohe pikët për të arritur rezultatin dhe për tu pranuar në institucionin e Arsimit të Lartë. Vitin e fundit u përpoqëm të shpërndanim maksimalisht informacionin mbi sistemin Meritë-Preferencë (MeP). Në këtë pikë ka ende për të bërë vit pas viti, në mënyrë që zgjedhja e 10 preferencave të mos jetë rezultat i një vendimi të çastit apo të influencave që nganjëherë të çojnë në vendime individuale që nuk përputhen me realitetin dhe mund të shkaktojnë zhgënjim, por të jetë një vendim gjithmonë personal dhe përgjegjësinë duhet ta mbajë gjithkush që merr këtë vendim. Kryesorja është që të jetë vendim i mirë informuar. Para se maturanti të zgjedhë p.sh. fakultetin e shkencave të natyrës, të inxhinierisë, apo historisë duhet të dijë më parë se ekziston një program i tillë studimi, me këtë ngarkesë dhe më kryesorja pas diplomimit, cilat janë shanset e punësimit apo të të qenit të suksesshëm në tregun e punës, pasi*

*të gjithkush mund edhe të nisë vetë diçka, në kuadrin e ekonomisë së tregut.*

*Kjo është ajo që ne këtë vit kemi vendosur të plotësojmë dhe për këtë folëm edhe në konferencën kombëtare për Maturën Shtetërore që u mbajt në dhjetor të vitit të kaluar.*

*Por unë do të falënderoja shumë për zemërsisht universitetin “Zoja e Këshillit të Mirë” për këtë iniciativë që ndërmer bashkë me ne, për të dhënë përvojën italiane për të dhënë përvojat tona midis shkollave të mesme dhe universiteteve shqiptare dhe për të ndihmuar për të caktuar hapat e mëtejshme për të cilat ne kemi kohë që po punojmë.*

*Dhe në këto hapa parashikojmë që të ndërtojmë një plan për të gjitha universitetet e vendit, në radhë të parë për ato publiket që janë në përgjegjësinë e ministrisë, por shpresojmë që në këtë proces të përfshihen edhe universitetet private. Në mënyrë që kontakti që ata kanë me shkollat e mesme të mos kufizohet vetëm për koeficientet që kanë për çdo universitet, por të ketë ditë të caktuara në kuadrin e planit mësimor, që profesorët e universiteteve vijnë në gjimnaze dhe në shkollat profesionale për të paraqitur ofertat e tyre dhe për të thithur maurantët drejt fakultetit të tyre; ashtu siç do ketë ditë të maurantit në fakultete, ku secili që mbaron shkollën e mesme, të mund të vizitojë sa më shumë fakultete, të njihet me godinën, me personelin, me laboratorët, me programet e studimit dhe të krijojë një ide që pas 3 apo 5 vjetësh pasi të diplomohet, çfarë do bëhet me të dhe çfarë shansesh do të ketë për punë, gjë që është e vështirë të përcaktohet, por një ide fillestare duhet të jepet.*

*Ky është një proces i zhvillimit të arsimit tonë të mesëm dhe të lartë, një proces që ne e kemi gjetur inegzistent, por që duhet ta zhvillojmë dhe këtu partnerët janë të shumtë dhe përvoja e huaj shërben si një model për ta përshtatur sipas nevojave tona. Prandaj do të doja të përshëndesja të gjithë ju që keni organizuar takimin e sotëm, i cili jam i sigurt do jetë i frytshëm për të gjithë ne!”*

Pas kësaj konference të mbajtur për herë të parë për Këshillimin e Karrierës në muajt në vazhdim takime të njëjta të quajtura “Ditët e gjimnazistëve në universitet” do të zhvillohen me pjesëmarrës maurantë, të cilët në verë të këtij viti, do të aplikojnë për degë të ndryshme të universiteteve.

Objektivi është që këta maurantë, por edhe maurantët e ardhshëm, para provimeve të Maturës dhe para se të zgjedhin

mes shumë fakulteteve në vend, të kenë një informacion të plotë për degët që ata do të zgjedhin për të studiuar, pritshmërinë e diplomës së tyre, aksesin në tregun e punës, familjarizimin me jetën studentore, si dhe tu jepet një ndihmë në marrjen e një vendimi të rëndësishëm për të ardhmen dhe karrierën e tyre, në mënyrë të mirë informuar e të bazuar.

## **KËRKESAT DHE NEVOJAT PËR ARSIMIN UNIVERSITAR NË SHQIPËRI**

**Halit Shamata**

Zëvendësministër i Arsimit dhe i Shkencës

*Nuk është krejt e rastit që jemi mbledhur në Universitetin “Zoja e Këshillit të Mirë”, në një konferencë që lidhet me këshillimin e nxënësve për zgjedhjen e studimeve universitare.*

*Le të urojme që ky takim të një jete një takim i këshillës së mirë dhe të falënderojmë nismëtarët dhe organizatorët e këtij evenimenti i cili mendoj që zhvillohet në kohën e duhur dhe do të shërbejë për të orientuar të rinjtë shqiptarë në mirëzgjedhjen e profesioneve, bazuar në përvojat më të mira.*

*Arsimi shqiptar, si një nga prioritetet e programit të Qeverisë shqiptare, është përfshirë në një reforme tërësore në të gjitha nivelet e sistemit, të arsimit parauniversitar, ashtu edhe të atij universitar. Në mënyrë të veçantë, reforma në arsimin e lartë synon formimin e të diplomuarve me njohuri shkencore e profesionale të cilësisë së lartë për të qënë të aftë të konkurrojnë në një ekonomi në hapje dhe zhvillim si dhe në përputhje me proceset integruese e globalizuese. Programi i qeverisë gjithashtu synon masivizimin e dijës universitare **duke mbështetur e nxitur shkollat e larta publike që të hapin dyert për të rinjtë shqiptarë.***

*Ministria e Arsimit dhe Shkencës, nëpërmjet politikave të saj ka bërë të mundur që gradualisht të rritet në mënyrë shumë të ndjeshme dhe të dukshme numri i pranimeve të reja në shkollat e larta të vendit, të cilën mund ta ilustrojmë si më poshtë:*

- o Në vitin **2004**, janë pranuar **74%** e atyre që mbaruan shkollën e mesme;

- Në vitin **2005**, janë pranuar **82%** e nxënësve që kanë kryer shkollën e mesme;
- Në vitin **2006**, janë pranuar **91%** e nxënësve që kanë kryer shkollën e mesme;
- Në vitin **2007**, janë pranuar **22995** studente ose mbi **97%** e nxënësve që kanë kryer shkollën e mesme.

*Pranimet e reja në shkollat e larta, nëpërmjet Maturës Shtetërore, tashmë është një reformë e realizuar dhe mbi këtë baze MASH po punon për konsolidimin dhe përmirësimin e hallkave të ndryshme të sistemit arsimor.*

*Në procesin për realizimin e Maturës Shtetërore moment shumë i rëndësishëm është sigurimi në nivel të lartë i informimit të nxënësve, prindërve dhe, në veçanti, informimi i nxënësve për studimet universitare.*

*Kjo kërkon cilësi, saktësi për njohjen e procesit nga të gjithë aktorët e interesuar dhe të përfshirë në proces; MASH ka menaxhuar informimin deri në nivel shkolle dhe individit si dhe ka ngritur e organizuar struktura për konsolidimin e procesit*

*Veç saj është organizuar përfshirja e institucioneve të AL në procesin informues e këshillues për maturanët, sidomos me njohjen e përmbajtjes së programeve universitare dhe perspektivës për degët e ndryshme. Ne jemi në fillim të një procesi njohës e këshillues përmes organizimit të ditëve të hapura të universiteteve për të gjitha shkollat e mesme të vendit.*

*MASH e ka konsideruar median si mjet shumë efikas për sigurimin e informacionit dhe këshillimin deri në nivel nxënësi, duke siguruar përmes saj:*

- *Prezantimin dhe njohjen e eksperiencës vendore, rajonale e më gjerë;*
- *Njohjen dhe pasqyrimin e këshillimit për të hapësirat e grupet e interesit në funksion të karrierës;*
- *Organizimi dhe realizimi i spoteve të vazhdueshme televizive për aspekte të rëndësishme dhe delikate të procesit;*
- *Bisedat televizive në studio me pjesëmarrje të nxënësve dhe mësuesve;*
- *Takimet e organizuara në shkolla të mesme të vendit;*
- *Organizimi dhe pasqyrimi i debateve ndërmjet shkollave të mesme dhe universiteteve për çështje të koeficienteve të*

*pranimit si një element i autonomisë dhe “çmimeve të tregut universitar”;*

- *Hapja e forumit “Online” në adresën e MASH, e cila rezultoi mjaft efektive. Jo vetëm nxënësit nga i gjithë vendi por dhe aktorë të tjerë të interesuar për procesin e MSH debatonin dhe informoheshin për këtë proces;*
- *Hapja e një rubrike të posaçme në gazetën “Mësuesi” për dhënien e një informacioni me të specializuar për procesin e MSH;*
- *MASH, përgatiti “Guidën e MSH” e cila u botua në kopje të konsiderueshme për të gjitha shkollat dhe përmblidhte të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për procesin e MSH, për të cilën nxënësit domosdoshmërisht duhet të informoheshin si: lëndët e provimeve të detyruara dhe menynë e lëndëve të provimeve me zgjedhje, rregullorja për zhvillimin e provimeve të MSH, shembuj të mënyrës së llogaritjes së pikëve në bazë të rezultateve dhe formulës si dhe rubrika pyetje dhe përgjigje rreth procesit të MSH;*

*Analiza e ecuresë së zhvillimit të maturës shtetërore detyroi zhvillime të reja gjatë procesit të maturës shtetëror:*

- *Sistemi Meritë-Preferencë, i prezantuar gjatë MSH ‘2007, synoi në orientim më të qartë drejt përzgjedhjes së degëve të universitetit, mbështetur në aftësitë e nxënësve si dhe ne ofertën universitare;*
- *MASH, duke analizuar procesin 2 vjeçar të MSH, në drejtim të këshillueshmërisë për përzgjedhjen e shkollës së lartë për ka ndërmarrë këto hapa:*
  - *Ka përmirësuar detyrat që do të kryejnë KSHMSH. Sipas udhëzimit një nga drejtuesit e shkollës, këtë vit do të ngarkohet me detyrë të drejtpërdrejtë për menaxhimin e këshillimtarisë së karrierës, duke i krijuar hapësirën e dhe mundësitë adekuate për organizimin e procesit.*
  - *Lidhur me orientimin për të ndjekur universitetet një grup pune pranë MASH, po punon për ngritjen e zyrave për këshillimin e karrierës për nxënësit e arsimit parauniversitar dhe për studentët që mbarojnë studimet e larta. Ideja është që MASH, duhet të marrë përgjegjësinë për të mbështetur nga ana ligjore dhe infrastrukturore hapjen dhe mirëfunksionimin një Zyre për Këshillimin e Karrierës, për të asistuar:*

- *Orientimin e të rinjve të arsimit parauniversitar në tregun e punës;*
- *Orientimi i hershem dhe i vazhdueshëm për të ndjekur universitetet në përputhje me prirjet dhe meritat;*
- *Këshillimin personal për të rinjtë për problemet që ata kanë;*
- *Këshillim për stafin e ri që rekrutohet për herë të parë në institucionet arsimore;*
- *Dhënien e informacionit Online për mënyrën e pranimit në universitete për nxënësit e arsimit parauniversitar;*
- *Dhënia e informacionit Online për tregun e punës në rafshin rajonal dhe kombëtar për nxënësit e arsimit të mesëm profesional dhe studentëve që diplomën në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL);*
- *Këshillimin e nxënësve të arsimit 9-ujeçar për t'i orientuar drejt përzgjedhjes së arsimit të mesëm, sidomos atij profesional;*
- *Këshillimi me prindërit e të rinjve për mundësitë e karrierës së fëmijëve të tyre.*

*Me gjithë punën e bërë si nga ana institucionale ashtu edhe ajo mediatike, rezultoi se një pjesë e maturantëve patën probleme që çuan deri në mos fitimin e asnjë dege në arsimin e lartë. Kjo edhe për arsye se KSHMSH-ja e përfshirë në realizimin e gjithë procesit të MSH nuk i kushtoi kohën e nevojshme këshillimit të nxënësve për zgjedhjen e degëve dhe plotësimin e saktë të formularëve.*

*Po paraqes disa të meta që u vunë re vitin e kaluar për arsye të mungesës së këtij këshillimi të maturantëve.*

- 1.** *Në shumë raste dokumentacioni për përcaktimin e fakulteteve sipas preferencave u plotësuan nga mësuesit, nxënësit u treguan neglizhentë.*
- 2.** *Në mjaft raste nxënësit plotësuan dokumentacionin formalisht duke iu referuar shokut të bankës.*
- 3.** *Nxënësit nuk kuptuan rëndësinë e renditjes së preferencave dhe mekanizmin e fitimit në një preferencë të caktuar, nuk morën parasysh rezultatet e tyre gjatë katër viteve, në mjaft raste preferencat u plotësuan si në një lojë me idenë se në një nga degët do të dalë fitues.*
- 4.** *Duke qenë se për herë të parë u shpallën të gjitha degët e Universiteteve, nxënësit menduan (sepse nuk u këshilluan) se mund të fitonin në top degët e zgjedhura prej tyre, pa*

*marrë parasysht kërkesat e të tjerëve dhe sidomos kuotat e secilës degë.*

*Kështu:*

- *Për 350 vende në degën Histori në Fakultetin Histori Filologji kishte 19615 kërkesa;*
- *Për 400 vende në degët Psikologji, Punë Sociale, Shkenca Politike kishte 27918 kërkesa;*
- *Për 1250 vende në Fakultetin Ekonomik, kishte 24011 kërkesa;*
- *Për 510 vende në Fakultetin e Mjekësisë, kishte 13524 kërkesa;*
- *Për 100 vende në Arkitekturë, kishte 1161 kërkesa;*
- *Për 380 vende në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike, kishte 7881 kërkesa;*
- *Për 460 vende në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit kishte 8245 kërkesa;*
- *Për 410 vende në Fakultetin e Infermierisë kishte 10228 kërkesa.*

*Këto tregojnë se maturanët nuk kishin këshillimin e duhur për zgjedhjen e degës sipas rezultateve të arritura.*

*Edhe prindërit e nxënësve, në shumë raste ishin të paqartë nuk udhëzuan drejt fëmijët e tyre, duke pretenduar për degët e top listës.*

*Kjo kërkon të forcohet bashkëpunimi dhe bashkëpërgjegjësia individuale, institucionale dhe shoqërore në mbështetje të karrierës.*

*Arsimi dhe përgatitja e brezave të ardhshëm për jetën është një përgjegjësi e detyrim sa personal e individual aq edhe mbarë shoqëror. Zgjedhja efektive e drejtimeve për karrierën përbën hapin e parë për sukses personal e shoqëror. Në këtë këndvështrim, përgjegjësia është jo vetëm personale e sektoriale por mbarë shoqërore. Kësisoj, kërkohet të punojmë e të bashkëpunojmë më shumë në këtë drejtim sidomos sa i takon institucionalizimit të procesit, rritjes së ekspertizës, shkëmbimit dhe implementimit të përvojave të suksesshme nga vendet e rajonit e më gjerë.*

- *Masat e marra nga MASH dhe Institucionet e Arsimit të Lartë lidhur me hapjen e degëve të reja, me shtimin e diplomave, si dhe krijimi i kushteve për shkollim e studim*

*të studentëve e pedagogëve është një zhvillim premtues dhe me efekte të shpejta në karrierë dhe në progresin ekonomik e social;*

- *Lidhja me tregun e punës në arsimin e lartë por edhe atë profesional është një këshillim invitro që ka një impakt madhor lidhur këshillimin dhe orientimin për karrierën;*
- *Projeksioni i nevojave afatmesme dhe afatgjata në rrafsh kombëtar, rajonal dhe gjer në nivel komunitetesh më të vogla për njerëz të shkollimeve dhe profesioneve të ndryshme;*
- *Krijimi dhe organizimi i forumeve lidhur me analizën e zhvillimit ekonomik e social duhet të jenë në radhë të parë pjesë e veprimtarisë hulumtuese e promovuese e shoqatave studentore dhe të biznesit, krahas strukturave shtetërore dhe institucioneve të specializuara.*

*I gjithë ky proces duhet të jetë një zhvillim mbështetës dhe bashkëpërgjegjësish, për të siguruar një progres të vazhdueshëm e të qëndrueshëm.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

---

Nr. 840 Prot

Dt.06.02.2008

**MIRATOHET  
MINISTRI**

**GENC POLLO**

**PROGRAM PUNE**

***“Ditët e gjimnazistëve në Universitete”***

Nën kujdesin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës Z. Genc Pollo në kuadrin e reformave të gjithanshme në arsim, rëndësisë që qeveria jonë i ka kushtuar arsimit, duke e shpallur atë prioritet kryesor kombëtar, e ndërgjegjshme se me një arsim masiv dhe cilësor realizohet një shoqëri e nesërme më e avancuar, më e mirë, e aftë për të ecur përpara dhe për të konkurruar me hapa më të shpejta në tregjet globale, orientimi i të rinjve në zgjedhjen e studimeve universitare apo i quajtur ndryshe Këshillimi i Karrierës për maturantët, përbën tashmë një iniciative tjetër të MASH.

**I. Këshillimi i Karrierë në shkollë dhe rezultatet që priten nga ky proces**

Objektivi është që nxënësit aktualisht maturantët e shkollave të mesme publike dhe jo-publike, por edhe maturantët e ardhshëm, para provimeve të Maturës dhe para se të zgjedhin mes shumë fakulteteve në vend, të kenë një informacion të plotë për degët që ata do të zgjedhin për të studiuar.

- Kjo është një nga pikat kyçe për një vendim personal të çdo kandidati/ maurant, e që duhet të merret në bazë të një informim të plotë, me anën e disa mekanizmave siç janë

Këshillimi i Karrierës dhe “Ditët e gjimnazistëve në universitet”;

- Orientimi i atyre që përfundojnë shkollën e mesme apo profesionale dhe drejtohen drejt universiteteve, është diçka shumë e rëndësishme, që ka munguar dhe që patjetër duhet të konsiderohet si prioritet për mbarëvajtjen e procesit të MSH;
- Këshillim për të gjithë nxënësit e shkollave të mesme, duke u përqendruar te maturantët, të cilët zgjedhin shkollën e lartë, por jo duke u kufizuar te ata. Ky proces është menduar që në një të ardhme të afërt të kaloj përmes ngritjes dhe funksionimit të Zyrave të Këshillimit të Karrierës (ZKK);
- MASH ka bërë përpjekjet maksimale për informimin e drejtë të maturantëve, por gjithsesi këshillimi permanent në shkollat e mesme i mbështetur, në një bashkëpunim të ngushtë me Universitetet dhe fakultetet, do të sillte rezultate më pozitive;
- Rezultati i procesit të Këshillimit të Karrierës, është që maturantët të jenë të mirinformuar, për vendimin që do të marrin. Para se maturanti të zgjedhë p.sh. fakultetin e shkencave të natyrës, të inxhinierisë, apo historisë duhet të dijë më parë se ekziston një program i tillë studimi, me ngarkesë të caktuar dhe më kryesorja pas diplomimit, cilat janë shanset e punësimit apo të të qenit të suksesshëm në tregun e punës.

## **II. Bashkëpunimi me Universitetet**

1. Për të garantuar një mbarëvajtje sa më të mirë të procesit të Këshillimit të Karrierës, do të ketë një bashkërendim të veprimtarive të parashikuara në plan-program mes shkollave të larta DPAL dhe DK.
2. Shkollat e Larta në bashkëpunim me DPAL dhe DK kanë detyrë që të informojmë më mirë maturantët për ofertat e Arsimit të Lartë, për shanset që kanë në një degë të caktuar studimi, për perspektivën e karrierës së tyre që u ofrohet në rastet e ndryshme.
3. Ky bashkëpunim do të përfshijë gjerësisht të gjitha Universitetet publike si edhe universitetet private, për të garantuar një hapësirë sa më të gjerë të plotësimit të interesave të nxënësve maturantë.

4. Maturantët do të informohen nga Fakultetet për vlefshmërinë e diplomës së tyre, hapësirën që ajo ka në tregun e punës, familjarizimin me jetën studentore, si dhe kushtet e mësimdhënies që ofrohen.
5. Takimet që do të organizojnë pjesëtarë të stafëve mësimore të fakulteteve, të mos kufizohet vetëm për çështje të koeficienteve që kanë për çdo universitet, por në ditë të caktuara në kuadrin “Ditët e gjimnazistëve në universitet”, profesorët e universiteteve vijnë në shkollat e mesme për të paraqitur ofertat e fakulteteve në të cilat ata japin mësim.
6. Maturantët vizitojnë në ditë të caktuara fakultetet, ku secili mund të vizitojë sa më shumë fakultete, të njihet me godinën, me personelin, me laboratorët, me programet e studimit dhe të krijojë një ide që pas 3 apo 5 vjetësh pasi të diplomohet, si dhe për të krijuar një ide fillestare çfarë shansesh do të ketë për punë.

### **PROGRAMI I VEPRIMTARIVE**

Janar 2008: Takimi i organizuar nga DPAL dhe DK me përfaqësues të DAR Tiranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Gjeologjisë.

Synimi: Kontributi dhe përgjegjësitë në përgatitjen e “Ditës së maturantit”

**Kohëzgjatja** për përgatitjen e situatës në secilin institucion 2 javë.

Veprimtaria: Shpallja e nismës “Ditët e Gjimnazistëve në Universitete”

Data 5.2. 2008

Vendi: Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Tiranë

Kryeson veprimtarinë: Z. Genc Pollo, Ministër i Arsimit dhe i Shkencës

Programi i veprimtarive “Ditët e Gjimnazistëve në Universitete” do të realizohet në dy faza:

Faza parë:

**“Pedagogët në shkolla”**

Kohëzgjatja 11 Shkurt deri më 11 Mars 2008

Synimi: Prezantim i programeve të studimit të fakulteteve në shkollat e mesme në shkallë republike.

Mënyra e prezantimit: Biseda prezantuese, materiale orientuese dhe njohëse të përgatitura nga secili fakultet.

Shkollat e mesme do të krijojnë mundësinë që jo vetëm nxënësit maturantë por edhe prindërit e tyre të ndjekin këto takime.

1 - 8 Shkurt 2008

DPAL dërgon në DK kalendarin e datave të planifikuara nga Universitete e fakultetet përkatëse për vizitat në shkollat e mesme.

8 - 11 shkurt 2008

DK do të njoftojë DAR për data e vizitës së pedagogëve në shkolla

11 - 15 shkurt 2008

DAR hartojnë grafikun dhe njoftojnë shkollat për caktimin e orëve të bisedave dhe njoftimin e të interesuarve përveç nxënësve.

Materiale në ndihme të procesit:

Postera

Fletëpalosje

Guida, etj

Faza e dytë

**“Maturantët në universitete”**

Pas përfundimit të turit njohës të pedagogëve në shkolla do të fillojnë vizitat e nxënësve të shkollave të mesme në fakultete.

Periudha:

15 Mars deri më 15 Maj 2008

Synimi: Njohja nga afër e mjediseve universitare, takim me pedagogë dhe studentë. Vizita në laboratorë dhe mjedise të tjera.

Kalendari i veprimtarive: Fakultetet shpallin datat për “Ditët e gjimnazistëve në Universitete” të cilat organizohen 1 herë në dy javë për çdo fakultet.

Në bazë të datave të planifikuara nga fakultetet, drejtorët e shkollave organizojnë vizitat e fakultete.

Bashkëngjitur janë dy tipa kërkesash për planifikimin e veprimtarive.

## V. SHPJEGIME PËR LLOGARITJEN E PIKËVE DHE SHEMBUJ NGA FITUESIT NË VITIN UNIVERSITAR 2007-2008

### **PIKËT DHE NOTAT E FITUESIT TË FUNDIT SIPAS SISTEMIT MERITË-PREFERENCË**

Për tu ardhur në ndihmë maturantëve, që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në Institucionet e Arsimit të Lartë Publik, në kuadrin e këshillimit për karrierë, po vëmë në dispozicion të tyre të dhëna të nxjerra nga përcaktimi i fituesve vitin universitar 2007-2008. Këto të dhëna i përkasin **fazës së dytë të shpërndarjes** së kandidatëve fitues. Të dhënat jepen në tabelën e mëposhtme dhe përfaqësojnë pikët dhe notat e fituesit të fundit, në fazën e dytë, për çdo program studimi në IAL.

*Shpjegime për interpretimin e tabelës.*

1. Në kolonën e parë janë renditur sipas universiteteve, programet e studimit me numrin që ishin koduar vitin e kaluar.
2. Në kolonën e dytë, janë kuotat e pranimit për vitin universitar 2007-2008.
3. Në kolonën e tretë p.sh. Dega 018 Greqisht, Kuota 50, **Nr.105: 3712.8p:**
  - Nr. 105 përfaqëson renditjen e kandidatit në të gjithë kërkuesit e kësaj dege. Ky kandidat është fituesi i fundit, i 50-ti, në atë program studimi që ka 50 vende, pavarësisht se renditet i 105. Kjo tregon se kandidatët me pikë më shumë se ky fitues i fundit (i renditur 105), kanë fituar në programe të tjera, që i kanë kërkuar në preferencë më të lartë.
  - 3712.8p tregon pikët e këtij kandidati të fundit fitues. Asnjë kandidat, me pikë më pak se ky, nuk është fitues në këtë degë.
4. Në kolonat 4, 5, 6 jepen notat e shkallëzuara të këtij fituesi të fundit dhe konkretisht:
  - NM - nota mesatare e shkollës së mesme,
  - D<sub>1</sub> - nota e marrë në provimin e parë të detyruar,
  - D<sub>2</sub> - nota e marrë në provimin e dytë të detyruar.
5. Në kolonat 7, 8 jepen notat që ka marrë fituesi i fundit në provimet me zgjedhje, ku numri në kllapa përfaqëson

provimin me zgjedhje që ka dhënë ky nxënës. Vitin e kaluar provimet me zgjedhje kanë qenë: (1) Fizikë, (2) Kimi, (3) Biologji, (4) Anglisht, (5) Histori - Gjeografi, (6) Njohuri për Shoqërinë, Ekonominë, Filozofinë, (7) Letërsi, (8) Matematikë. Pra **(6) 6.70**, tregon se nxënësi ka dhënë provimin Njohuri për Shoqërinë, Ekonominë, Filozofinë dhe ka marrë notën e shkallëzuar 6.70.

*Duke patur parasysh, se formula llogaritëse e pikëve, vitin e kaluar ka qenë:*

$$[(D1 + D2 + M) \times Ksh + Z1 \times K1 + Z2 \times K2]$$

Ku: Ksh - është koeficienti i shkollës, K1 - koeficienti për provimin e parë me zgjedhje dhe K2 - koeficienti për provimin e dytë me zgjedhje, secili nxënës, mund të llogarisë afërsisht sa pikë mund të fitojë, duke njohur vlerësimet e veta (parashikimet), pra duke vetëvlerësuar veten. Në këtë mënyrë do të orientohet më mirë për të kërkuar programin e studimit që dëshiron të vazhdojë në Institucionet e Arsimit të Lartë Publik.

Renditja dhe shpallja e fituesve për programet e studimit, të cilat kishin si kusht edhe konkursin e veçantë, si Arkitektura, Edukimi Fizik, degët e Akademisë së Arteve etj., është bërë me formulë tjetër matematike. Në këto raste është marrë parasysh pikëzimi në konkurse, përveç pikëve të marra në provimet e Maturës Shtetërore.

#### FAZA E DYTE

Emërtimi i degës (program studimi)	Kuota 2007- 2008	Fituesi i fundit	NM	D1	D2	Z1	Z2
<b>UNIVERSITETI TIRANES</b>							
001 HISTORI	100	Nr.687: 4904.9p	9.06	6.60	7.64	(6) 7.73	(5) 6.70
002 GJEOGRAFI	100	Nr.646: 4849p	8.02	7.64	6.64	(5) 7.84	(6) 7.16
003 GJUHË-LETËRSI	100	Nr.642: 4884p	6.60	7.77	5.64	(6) 8.52	(5) 7.50
004 GAZETARI	50	Nr.753: 5161.8p	8.00	8.00	8.00	(6) 8.41	(4) 5.45
005 KIMI	60	Nr.446: 4723.8p	8.40	7.12	5.24	(2) 7.84	(4) 6.14
006 BIOLOGJI	120	Nr.569: 4725.6p	8.15	5.81	6.07	(3) 7.39	(4) 7.39
007 MATEMATIKË	120	Nr.570: 4252.7p	7.10	6.33	6.50	(1) 5.57	(4) 5.68
008 FIZIKË	120	Nr.271: 2812p	5.50	5.00	5.00	(5) 6.48	(6) 6.14
009 INFORMATIKË	70	Nr.418: 5486.6p	8.25	6.33	8.36	(1) 8.52	(2) 8.98
010 KIMI USHQIMORE	60	Nr.331: 4633.3p	7.26	5.42	7.22	(2) 7.39	(1) 6.82
011 KIMI INDUSTRIALE	60	Nr.346: 4608.9p	8.34	5.94	6.50	(2) 7.39	(3) 7.39
012 INXH. MATE. DHE FIZIKE	80	Nr.178: 2954p	5.36	6.00	5.00	(5) 6.93	(6) 6.25

013 ANGLISHT	200	Nr.956: 4470.2p	8.57	5.68	7.78	(6) 6.93	(5) 6.93
014 FRËNGJISHT	100	Nr.237: 3881.4p	6.02	5.94	5.92	(4) 6.14	(5) 5.80
015 GJERMANISHT	110	Nr.253: 3763.4p	5.94	7.12	5.92	(5) 6.48	(6) 6.48
016 ITALISHT	110	Nr.510: 4129p	6.05	6.00	6.00	(5) 7.50	(6) 8.52
017 GJUHË SLLAVE BALLKANIKE	30	Nr.71: 3765p	5.74	6.60	6.36	(6) 6.36	(5) 5.11
018 GREQISHT	50	Nr.105: 3712.8p	7.14	6.60	5.12	(6) 6.70	(5) 5.91
019 TURQISHT	30	Nr.65: 3484.8p	7.34	6.00	5.00	(5) 6.25	(6) 6.59
020 PSIKOLOGJI	100	Nr.1054: 5066.3p	9.17	6.20	6.36	(6) 7.84	(5) 7.73
021 PUNË SOCIALE	100	Nr.958: 5047.6p	8.80	7.12	5.37	(4) 7.95	(6) 7.95
022 FILOZOFI- SOCIOLOGJI	100	Nr.731: 4857.4p	7.71	7.64	4.99	(6) 7.73	(5) 7.73
023 SHKENCA POLITIKE	100	Nr.1003: 5192.8p	9.62	6.46	7.50	(3) 7.84	(4) 8.52
024 ADMINISTRIM- BIZNES	460	Nr.1925: 4655.3p	7.50	5.81	6.36	(4) 7.84	(6) 8.30
024/1 ADMINISTRIM- BIZNES (KUKES)	100	Nr.91: 2682p	5.28	4.50	4.99	(5) 6.48	(3) 5.57
025 EKONOMIKS	70	Nr.961: 4883.8p	8.30	6.86	8.36	(5) 8.07	(6) 7.84
026 FINANCE	460	Nr.1438: 4876.3p	8.47	6.60	7.78	(6) 7.50	(4) 7.16
027 INFORMATIKË EKONOMIKE	60	Nr.582: 5031.7p	8.60	8.04	7.64	(2) 8.86	(4) 7.61
028 TURIZËM	200	Nr.610: 4213.5p	9.19	7.12	5.78	(5) 6.02	(6) 7.39
029 MJEKËSI E PËRGJITHSHME	250	Nr.535: 5721.4p	9.98	7.12	8.78	(2) 7.50	(3) 8.64
030 FARMACI	80	Nr.371: 5799.3p	9.50	8.56	8.07	(2) 8.52	(4) 7.95
031 STOMATOLOGJI	100	Nr.317: 5857.5p	9.82	6.60	8.64	(1) 8.64	(2) 9.43
032 SHËNDETI PUBLIK	80	Nr.248: 4884.5p	7.34	5.02	6.92	(1) 7.95	(2) 8.86
033 INFIERMIER I PËRGJITHSHËM	250	Nr.588: 4842.1p	7.28	7.12	6.36	(2) 7.16	(3) 7.73
034 MAMI	50	Nr.146: 4521.1p	8.66	5.81	4.74	(2) 7.73	(3) 6.36
035 LABORANT	35	Nr.209: 5457.6p	8.14	7.38	7.64	(2) 7.95	(3) 9.09
036 FIZIOTERAPI	30	Nr.196: 5324.1p	9.57	6.73	6.64	(2) 8.30	(3) 7.95
037 LOGOPEDI	15	Nr.81: 4807.4p	8.43	6.60	7.07	(1) 7.73	(4) 5.45
038 IMAZHERI	30	Nr.133: 4847.9p	9.76	6.86	5.24	(1) 6.93	(2) 6.82
039 DREJTËSI	600	Nr.1306: 5137.1p	7.53	8.30	7.78	(5) 6.93	(6) 7.16
<b>UNIVERSITETI POLITEKNIK</b>							
040 INXH. NDËRTIMI	150	Nr.613: 5506.2p	8.70	6.46	7.92	(1) 8.98	(4) 8.52
041 INXH. HIDROTEKNIKE	100	Nr.261: 4362.1p	7.82	6.33	6.07	(2) 7.16	(4) 7.73
042 INXH. MJEDISI	50	Nr.398: 5056.3p	9.00	7.51	5.78	(1) 6.59	(2) 8.30
043 ARKITEKTURË	100	Nr.100: 57.32p	9.29	6.20	5.92	(4) 7.50	(6) 7.61
044 INXH. GJEODET	60	Nr.189: 4250.3p	6.41	7.12	5.64	(1) 5.57	(4) 6.48
045 INXH. ELEKTRIKE	70	Nr.282: 5030p	6.64	6.60	7.07	(1) 7.73	(2) 9.09
046 INXH. ELEKTRONIKE	50	Nr.417: 5540.3p	9.39	7.77	7.64	(1) 8.30	(2) 7.61
047 INXH. INFORMATIKE	100	Nr.491: 5318.3p	9.45	6.86	7.22	(2) 8.75	(1) 6.82

048 INXH. TELEKOMUNIKACIONI	100	Nr.497: 5193.8p	8.75	6.20	8.22	(2) 7.95	(1) 7.05
049 INXH. MEKATRONIKE	60	Nr.161: 3908.4p	7.06	4.63	4.62	(2) 6.14	(4) 6.36
050 INXH. FIZIKE	60	Nr.101: 3077p	6.50	6.65	5.12	(5) 6.48	(6) 6.02
051 INXH. MATEMATIKE	60	Nr.187: 2733p	5.06	5.00	5.00	(5) 5.91	(6) 6.36
052 INXH. MEKANIKE	150	Nr.341: 4187.6p	7.66	8.17	4.99	(4) 7.84	(5) 6.70
053 INXH. TEKSTILE DHE MODE	60	Nr.190: 3984.5p	6.44	5.29	5.37	(4) 7.95	(3) 5.57
054 INXH. MATERIALE	89	Nr.63: 2916p	5.00	5.00	7.00	(5) 6.36	(6) 5.80
055 INXH. NE SHKENCAT E TOKES	70	Nr.134: 2844p	6.48	5.02	5.12	(5) 5.34	(6) 6.48
056 INXH. GJEONFORMATIKE	80	Nr.181: 3304.1p	6.03	5.94	4.74	(5) 6.36	(6) 8.30
057 INXH. GJEOBURIMEVE	150	Nr.186: 2698p	5.31	5.36	4.72	(6) 5.57	(5) 6.02
<b>UNIVERSITETI BUJQESOR</b>							
083 DREJTIM FERMASH E AGROBIZ.	250	Nr.469: 3798.6p	6.68	5.02	5.64	(6) 6.70	(7) 5.00
084 EKONOMI E POLITIKE AGRARE	250	Nr.639: 4091.5p	7.09	5.02	6.21	(1) 6.70	(6) 6.59
085 FINANCE-KONTABILITET	200	Nr.702: 4333p	10.00	6.46	5.24	(2) 6.70	(3) 6.25
086 INXH. AGR. HORTIKULTURE	100	Nr.170: 2999.7p	5.06	4.89	5.12	(3) 6.59	(5) 6.36
087 INXH. AGR. MBROJTJE BIMESH	50	Nr.108: 3465.2p	5.47	5.65	5.92	(6) 6.02	(5) 6.48
088 INXH. AGR. PRODHIM BIMOR	131	Nr.96: 2810p	5.60	5.00	5.00	(5) 6.25	(6) 6.25
089 I. AGR. ZOOT. BIZ. BLEKTORAL	108	Nr.72: 2610p	5.19	5.16	4.50	(5) 5.45	(6) 5.80
090 I. AGR. AKUAKUL. MAN. PESHK.	100	Nr.209: 2948.5p	5.70	5.00	5.25	(5) 6.14	(6) 5.80
091 AGROMJEDIS DHE EKOLOGJI	100	Nr.282: 3763p	5.93	5.55	6.07	(6) 6.36	(5) 6.70
092 TEKNOLOGJI AGROUSHQIMORE	100	Nr.242: 3867.8p	7.79	5.81	4.99	(4) 5.57	(5) 7.27
093 VRESHTARI DHE ENOLOGJI	50	Nr.126: 2967.3p	5.03	5.02	5.24	(3) 5.91	(5) 6.70
094 INXHINIERI PYJORE	50	Nr.176: 4124.4p	7.66	7.38	5.24	(5) 7.61	(6) 7.27
095 INXHINIERI DRURI	50	Nr.154: 3745.6p	5.45	5.93	5.31	(6) 6.48	(5) 7.61
096 VETERINARI	70	Nr.202: 3904.3p	6.07	7.25	6.64	(6) 8.52	(3) 6.59
<b>AKADEMIA KULTURES FIZIKE</b>							
097 MESUES I EDUKIMIT FIZIK	120	Nr.121: 63.72p	6.18	5.81	6.21	(5) 7.61	(6) 7.05
<b>UNIVERSITETI I ELBASANIT</b>							
098 GJUHE-LETËRSI	100	Nr.385: 4128.8p	6.84	6.73	5.24	(5) 6.36	(6) 6.59
099 HISTORI-GJEOGRAFI	80	Nr.407: 4316.6p	6.06	6.07	6.78	(6) 6.70	(5) 6.14
100 BIOLOGJI-KIMI	80	Nr.331: 3896.1p	5.45	6.00	5.00	(3) 6.82	(2) 6.70

101 MATEMATIKË-FIZIKË	199	Nr.175: 2645p	5.00	4.51	5.12	(5) 5.34	(6) 6.48
102 ANGLISHT	150	Nr.349: 3262.8p	5.89	6.46	4.99	(5) 6.14	(6) 5.68
103 GJERMANISHT	75	Nr.58: 2755p	5.03	4.65	4.91	(5) 6.48	(6) 6.48
104 FRËNGJISHT	122	Nr.101: 2701p	5.06	4.89	5.12	(5) 5.80	(6) 6.14
105 ITALISHT	50	Nr.203: 3469.1p	5.64	5.29	4.74	(5) 7.73	(6) 6.59
106 ÇIKËL I ULËT	200	Nr.527: 3844.3p	5.61	5.16	5.50	(6) 6.48	(5) 5.57
107 CU PARASHKOLLOR	100	Nr.286: 3100.5p	5.21	5.00	5.00	(5) 6.70	(6) 5.45
108 ADMINISTRIM-BIZNES	100	Nr.384: 3981.7p	5.98	5.94	6.07	(6) 7.73	(5) 8.18
109 FINANCË-KONTABILITET	100	Nr.334: 4110.4p	8.15	6.07	5.24	(2) 6.36	(3) 7.50
110 EKONOMIA DHE E DREJTA	100	Nr.400: 3759.7p	8.30	6.73	7.07	(8) 6.93	(6) 6.59
111 EDUKIM QYTETAR	100	Nr.385: 3872.3p	6.47	7.91	5.92	(5) 5.91	(6) 6.70
112 PUNONJËS SOCIAL	100	Nr.478: 4247.9p	6.67	6.60	4.62	(5) 6.48	(6) 6.93
113 GAZETARI	80	Nr.413: 4206.8p	6.62	5.55	4.74	(5) 7.95	(4) 7.50
114 FILOZOFI-SOCIOLOGJI	70	Nr.373: 4088.6p	5.83	6.20	4.62	(5) 6.25	(6) 7.27
115 PSIKOLOGJI	80	Nr.453: 4275.2p	7.10	6.33	5.50	(6) 6.48	(5) 6.02
116 INFIERMIER I PËRGJITHSHËM	150	Nr.394: 4195.8p	6.84	5.02	5.24	(2) 5.91	(3) 7.95
116/1 MAMI	100	Nr.192: 3745.2p	8.89	6.60	5.12	(5) 6.02	(6) 6.70
<b>UNIVERSITETI I GJIROKASTRES</b>							
117 HISTORI-GJEOGRAFI	70	Nr.221: 3859p	5.64	4.76	6.92	(5) 6.14	(6) 6.36
118 GJUHË-LETËRSI	60	Nr.265: 3452.5p	5.69	7.00	6.00	(5) 6.14	(6) 6.02
119 ADMINISTRIM-PUBLIK	60	Nr.209: 3656.3p	5.65	6.22	4.91	(3) 6.82	(6) 7.39
120 TURIZËM	50	Nr.255: 3415p	5.62	5.55	6.78	(5) 5.91	(2) 6.70
121 FINANCË	70	Nr.219: 3908.3p	5.87	4.51	6.54	(5) 7.27	(6) 6.25
122 ANGLISHT	100	Nr.154: 2973.5p	5.00	5.00	5.00	(5) 5.57	(6) 7.05
123 ITALISHT	337	Nr.130: 2744.3p	5.00	5.00	5.00	(5) 5.11	(3) 5.80
124 GREQISHT	180	Nr.47: 3088.6p	5.42	5.42	5.24	(2) 5.34	(3) 6.25
125 MATEMATIKË-FIZIKË	77	Nr.70: 2876.5p	5.30	5.00	5.00	(3) 5.34	(6) 6.25
126 MATEMATIKË-INFORMATIKË	93	Nr.137: 2797p	5.47	5.00	5.00	(6) 7.05	(5) 5.45
127 BIOLOGJI-KIMI	60	Nr.204: 2697p	5.40	4.76	4.99	(6) 5.91	(5) 5.91
128 INFIERMIERI	100	Nr.216: 3887.4p	5.82	4.94	5.92	(2) 5.80	(3) 6.14
129 ÇIKËL I ULËT	710	Nr.241: 2751p	5.60	5.00	6.00	(6) 5.91	(5) 5.00
130 ÇIKËL I ULËT PARASHKOLLOR	171	Nr.122: 2815p	5.56	6.00	5.00	(3) 5.68	(2) 5.91
<b>UNIVERSITETI KORÇËS</b>							
131 MARKETING	80	Nr.348: 3665.5p	5.76	5.68	5.37	(5) 6.59	(6) 7.61
132 ADMINISTRIM-BIZNES	60	Nr.277: 4110.5p	6.08	6.60	4.50	(3) 7.16	(6) 7.61
133 TURIZËM	80	Nr.387: 2732p	5.50	5.00	5.00	(2) 5.57	(3) 6.25

134 FINANCE	60	Nr.159: 4543.9p	6.73	7.12	5.92	(5) 7.27	(6) 8.07
135 ÇIKËL I ULËT	100	Nr.413: 2954.2p	5.06	5.16	4.86	(6) 6.48	(5) 6.14
136 ÇIKËL I ULËT PARASHKOLLOR	100	Nr.220: 2991p	5.68	6.20	4.62	(6) 7.16	(7) 6.25
137 ANGLISHT	120	Nr.191: 3457.8p	5.95	5.79	4.72	(2) 6.02	(3) 7.16
138 FILOZOFI- SOCIOLOGJI	80	Nr.337: 4234.3p	5.69	5.93	4.91	(5) 6.59	(6) 8.18
139 MATEMATIKË	100	Nr.119: 3182.6p	7.18	5.16	5.12	(6) 6.48	(7) 6.14
140 GJUHE-LETËRSI	100	Nr.375: 3949.4p	7.17	5.42	4.50	(5) 6.70	(6) 6.59
141 AGROBIZNES	284	Nr.206: 2775p	5.27	5.36	5.31	(3) 5.45	(5) 6.36
142 HORTIKULTURË	83	Nr.55: 3016.1p	5.25	4.51	6.68	(3) 5.57	(5) 6.48
143 INXHINIERI AGRONOMIKE	153	Nr.109: 2892p	6.20	5.08	4.91	(6) 6.93	(5) 5.80
144 INFIERMIER I PËRGJITHSHËM	120	Nr.315: 3920.5p	5.89	6.00	7.00	(5) 6.93	(3) 7.39
145 MAMI	40	Nr.170: 3046.4p	5.54	5.00	5.00	(2) 5.80	(3) 5.68
<b>UNIVERSITETI I SHKODRES</b>							
146 GJUHE -LETËRSI	120	Nr.368: 3987.4p	5.67	5.08	5.92	(5) 6.70	(6) 6.02
147 HISTORI	90	Nr.334: 4176p	6.41	5.81	5.37	(5) 6.25	(6) 6.93
148 GJEOGRAFI	90	Nr.414: 3953.8p	6.14	5.55	4.74	(5) 5.45	(6) 7.27
149 GAZETARI	60	Nr.273: 4471.9p	6.48	7.50	5.51	(5) 6.48	(6) 6.93
150 MATEMATIKË	195	Nr.160: 2591p	5.00	5.00	5.00	(5) 5.34	(6) 5.57
151 FIZIKË	91	Nr.75: 2929p	5.68	6.00	5.00	(5) 6.59	(6) 6.02
152 BIOLOGJI-KIMI	422	Nr.316: 2728p	5.00	5.00	5.00	(5) 6.14	(6) 6.14
153 INFORMATIKË	60	Nr.243: 3606.6p	6.12	5.00	5.00	(5) 7.84	(6) 7.27
154 INFIERMIERI	120	Nr.364: 4065.7p	7.46	10.00	5.00	(2) 6.59	(3) 5.68
155 MAMI	90	Nr.206: 3121.3p	6.53	5.00	5.50	(2) 5.91	(3) 5.00
156 FIZIOTERAPI	30	Nr.159: 4374.8p	8.89	7.51	4.62	(5) 7.27	(6) 7.05
157 ADMINISTRIM- BIZNES	80	Nr.369: 4299.9p	6.92	6.46	5.37	(5) 6.70	(6) 7.73
158 FINANCE- KONTABILITET	120	Nr.337: 4295.1p	6.41	6.07	5.92	(5) 6.70	(6) 8.07
159 TURIZËM	120	Nr.442: 3835.7p	6.56	6.60	4.62	(3) 5.34	(6) 6.25
160 ANGLISTIKË	200	Nr.371: 2870.3p	5.60	4.79	4.72	(3) 5.91	(4) 5.91
161 ITALIANISTIKË	65	Nr.201: 3191.2p	5.22	5.00	5.00	(5) 6.59	(6) 6.25
162 GJERMANISTIKË	50	Nr.32: 3697.9p	5.64	5.42	4.99	(5) 6.93	(4) 6.70
163 FRËNGJISHT	50	Nr.40: 3003.5p	5.00	5.42	4.99	(5) 5.45	(6) 5.80
164 ÇIKËL I ULËT	120	Nr.375: 3693.8p	6.66	4.89	5.12	(5) 6.59	(3) 6.70
165 ÇIKËL I ULËT PARSHKOLLOR	283	Nr.184: 2685p	5.15	5.00	5.00	(2) 5.68	(3) 6.02
166 PSIKOLOGJI	60	Nr.354: 4460.4p	7.15	6.20	5.64	(5) 6.59	(6) 7.27
167 PUNË SOCIALE	60	Nr.348: 4465.5p	6.22	7.07	5.71	(5) 8.30	(6) 7.05
168 EDUKIM FIZIK	60	Nr.69: 56.52p	5.33	5.42	5.31	(3) 5.91	(1) 5.45
169 DREJTËSI	100	Nr.384: 4793.5p	6.58	6.07	6.50	(5) 8.52	(6) 7.73
<b>UNIVERSITETI I VLORES</b>							

170 CIKËL I ULËT	150	Nr.559: 3853.8p	7.52	5.81	4.74	(3) 6.48	(6) 6.59
171 CIKËL I ULËT PARSHKOLLOR	410	Nr.296: 2820p	5.48	5.00	5.00	(3) 6.36	(2) 6.36
172 PEDAGOGJI E SPECIALIZUAR	30	Nr.188: 4388.8p	6.90	5.29	7.36	(5) 6.82	(6) 7.39
173 MATEMATIKE - FIZIKE	228	Nr.203: 2639p	5.00	5.29	4.74	(5) 5.45	(6) 5.91
174 TEKNOLOGJI INFORMACIONI	659	Nr.574: 2710p	5.10	4.94	5.12	(6) 5.80	(5) 6.14
175 GJUHE - LETËRSI	160	Nr.520: 4381.5p	6.13	7.25	5.78	(4) 6.25	(6) 6.82
176 ANGLISHT	200	Nr.604: 3204.5p	5.69	4.76	4.50	(2) 5.91	(3) 6.70
177 ITALISHT	200	Nr.705: 3457p	5.45	5.00	5.00	(5) 6.25	(3) 6.36
178 DREJTËSI	100	Nr.318: 4776.5p	8.06	7.51	5.78	(5) 6.82	(6) 6.93
179 ADMINISTRIM- BIZNES	240	Nr.724: 4170p	5.50	5.42	5.50	(3) 8.52	(2) 7.84
180 TURIZEM	200	Nr.729: 4097.2p	5.41	4.89	5.78	(5) 6.70	(6) 7.50
181 INXH. NAVIGACIONI	404	Nr.321: 2825p	5.75	5.00	5.00	(5) 6.14	(6) 6.36
182 INXH. NAVALE	479	Nr.354: 2790p	5.90	4.65	4.51	(5) 6.70	(6) 6.14
183 INFERMIERI	150	Nr.465: 4097.5p	5.76	6.60	5.78	(5) 7.50	(3) 7.61
<b>UNIVERSITETI I DURRESIT</b>							
184 ADMINISTRIM- BIZNES	180	Nr.639: 4403.7p	8.89	5.94	5.12	(2) 5.80	(3) 6.59
185 TURIZEM	180	Nr.627: 4001.1p	7.34	4.50	6.21	(5) 7.50	(6) 5.57
186 ANGLISHT	150	Nr.403: 3272p	5.51	7.50	4.50	(6) 6.25	(5) 5.45
187 CIKËL I ULËT	200	Nr.472: 3928.5p	6.24	5.00	5.00	(6) 6.59	(5) 6.14
188 EKSPERT PROC. E FORMIMIT	50	Nr.92: 3136.7p	5.22	6.36	4.72	(5) 5.45	(6) 6.14
189 ASISTENT LIGJOR	40	Nr.213: 4646.1p	8.20	6.73	6.92	(5) 7.73	(6) 7.84
190 ASISTENT ADMINISTRATIV	20	Nr.138: 4467.9p	6.98	6.73	5.12	(4) 5.91	(5) 8.18
191 INFERMIERI	60	Nr.232: 4114.8p	6.60	6.86	4.99	(5) 7.27	(6) 7.61
192 NDIHMES DENTIST	20	Nr.101: 4310.8p	6.43	4.89	6.50	(3) 9.20	(6) 6.14
193 SPEC RRJETASH KOMPJUTER.	40	Nr.174: 4125.3p	7.22	6.60	5.92	(6) 7.27	(5) 6.14
194 MENAXHIM NDËRTIMI	120	Nr.300: 3714.1p	5.79	5.42	4.86	(5) 6.36	(6) 6.14
195 MENAXHIM TRANSPORTI	120	Nr.305: 3043.4p	5.03	4.79	4.52	(5) 6.02	(6) 6.36
196 TEKNOLOGJI AUTOMOBILASH	100	Nr.221: 2819.9p	5.60	5.00	5.00	(5) 5.80	(6) 5.23

## **SHEMBUJ PËR FITUESIN E FUNDIT**

**1.** Fituesi i fundit në programin e studimit Histori (001), me 100 vende, ka mbaruar shkollën e mesme të gjuhëve të huaja për Anglisht (shkolla 10). Koeficienti i shkollës për këtë program studimi është 1.3. Ka dhënë si provim të parë me zgjedhje (6) Njohuri për Shoqërinë, Filozofinë, Ekonominë, që ka koeficientin 1.3 për këtë program studimi. Provim të dytë me zgjedhje ka dhënë (5) Histori - Gjeografi, që ka koeficientin 1.3. Llogaritja e pikëve për këtë maturantë bëhet sipas formulës:

$$[(D1 + D2 + M) \times Ksh + Z1 \times K1 + Z2 \times K2].$$

*Zëvendësojmë kufizat e kësaj formule me notat dhe koeficientet përkatës të këtij nxënësi dhe kemi:*

$$\begin{aligned} & [(6.60 + 7.64 + 9.06) \times 1.3 + 7.73 \times 1.3 + 6.70 \times 1.3] = \\ & (23.3 \times 1.3 + 14.43 \times 1.3) = 30.29 + 18.759 = 49.049. \end{aligned}$$

Duke shumëzuar me 100 marrim rezultatin **4904.9 pikë**.

Ky fitues, sipas pikëve është renditur i 687-ti në listën e kërkuesve të programit të studimit Histori. Është fituesi i 100 (i fundit), pasi të gjithë maturantët me pikë më shumë se ky (gjithsej 587 maturantë) kanë fituar në preferenca më të larta të tyre, që kanë qenë para preferencës 001.

**2.** Llogarisim dhe pikët e fituesit të fundit në programin e studimit Farmaci (030). Ky fitues ka mbaruar shkollën e mesme të profilizuar në profilin natyror (01). Koeficienti i shkollës për programin e studimit Farmaci është 1.4. Ka dhënë provimet me zgjedhje (2) Fizikë dhe (4) Anglisht, që për programin e studimit Farmaci, kanë koeficientin 1.3.

*Duke zëvendësuar notat e këtij fituesi dhe koeficientit, në formulën e mësipërme kemi:*

$$\begin{aligned} & [(D1 + D2 + M) \times Ksh + Z1 \times K1 + Z2 \times K2] = \\ & [(8.56 + 8.07 + 9.50) \times 1.4 + 8.52 \times 1.3 + 7.95 \times 1.3] = \\ & (26.13 \times 1.4 + 16.47 \times 1.3) = 36.582 + 21.411 = 57.993, \end{aligned}$$

që duke e shumëzuar me 100 kemi vlerësimin 5799.3 pikë.

Me këto pikë, ky nxënës është renditur në vendin e 371-të dhe është fituesi i 80-të, pasi nxënësit me më shumë pikë se ky dhe të renditur para tij, kanë fituar në preferencat e tyre më të larta.

## **SHEMBULL 1**

Drita ka aplikuar në Universitetin e Tiranës për të vazhduar studimet në degën e Farmacisë. Ajo ka mbaruar **shkollën e mesme të përgjithshme të profilizuar, profili natyror** dhe ka një **notë mesatare nga shkolla e mesme 8.34**.

Në **dy provimet e detyruara** ajo ka këto rezultate:

- Në Letërsi dhe Gjuhë Shqipe **8.72**
- Në Matematikë **9.15**

Ajo ka zgjedhur si **provime me zgjedhje**

- Fizikë
- Biologji

dhe ka si rezultate:

- Në Fizikë **9.23**
- Në Biologji **9.52**

*Ç'llogaritje duhet te kryeje për të gjetur sasinë e pikëve me të cilat do te renditet?*

Veprimi i parë:

**Në fillim** ajo sheh se cili është **koeficienti që ka caktuar Fakulteti i Mjekësisë për shkollën e mesme të saj**. Ajo sheh në tabelë dhe **gjen koeficientin 1.4**.

**Atëherë ajo kryen këto llogaritje:**

*Shumëzon:*

$$8.34 \text{ (nota mesatare e shkollës së mesme)} \times 1.4 \text{ (koeficienti i shkollës)} = 11.676$$

*Shumëzon:*

$$8.72 \text{ (nota në gjuhë-letërsi)} \times 1.4 \text{ (koeficienti i shkollës)} = 12.208$$

*Shumëzon:*

$$9.15 \text{ (nota në matematikë)} \times 1.4 \text{ (koeficienti i shkollës)} = 12.81$$

Veprimi i dytë:

**Pastaj** ajo sheh se **cili është koeficienti që Fakulteti i Mjekësisë ka zgjedhur për Kiminë dhe cili është koeficienti për Biologjinë**.

*Në tabelë gjen këta koeficiente:*

- Për Fizikën **1.3**
- Për Biologjinë **1.3**

Atëherë ajo kryen edhe këto **llogaritje te tjera**

*Shumëzon:*

$$9.23 \text{ (nota në Fizikë)} \times 1.3 \text{ (koeficienti për Fizikën)} = 11.999$$

*Shumëzon:*

$$9.52 \text{ (nota në Biologji)} \times 1.3 \text{ (koeficienti për Biologjinë)} = 12.376$$

Veprimi i trete:

Secili prej rezultateve te mësipërme shumëzohet me **100**:

$$11.676 \times 100 = 1167.6$$

$$12.208 \times 100 = 1220.8$$

$$12.810 \times 100 = 1281.0$$

$$11.999 \times 100 = 1199.9$$

$$12.376 \times 100 = 1237.6$$

Veprimi i katërt:

*Rezultatet mbliidhen:*

$$1167.6 + 1220.8 + 1281.0 + 1199.9 + 1237.6 = 6106.9$$

**Ky është rezultati me te cilin Blerina konkurren ne degën e Farmacisë!**

## SHEMBULL 2

Agimi aplikon në Universitetin e Tiranës ne Fakultetin Juridik.

Ai ka mbaruar një **Shkollë të mesme artistike** dhe ka **notë mesatare** nga shkolla e mesme **8.21**.

*Në **dy provimet e detyruara** ai ka këto rezultate:*

- Në provimin e Letërsi dhe Gjuhe shqipe ai ka **8.72**
- Në Provimin e formimit teorik profesional ai ka **9.15**

*Ai ka zgjedhur si **provime me zgjedhje:***

- Anglisht

- Sociologji + Ekonomi + Filozofi

*dhe ka si rezultate:*

- Në Anglisht **9.23**
- Në Sociologji + Filozofi + Ekonomi tregu **9.52**

*Ç'logaritje duhet te kryeje për të gjetur sasinë e pikëve me të cilat do të renditet?*

Veprimi i parë:

**Në fillim** ai sheh se cili është **koeficienti që ka caktuar Fakulteti i Drejtësisë në Universitetin e Tiranës për shkollën e mesme te tij**. Në tabele ai sheh dhe **gjen koeficientin 1.1**.

*Atëherë ai kryen këto llogaritje:*

*Shumëzon:*

8.21 (nota mesatare e shkollës së mesme) x 1.1 (koeficienti për llojin e shkollës) = 9.031

*Shumëzon:*

8.72 (nota në Letërsi dhe Gjuhë shqipe) x 1.1 (koeficienti për llojin e shkollës) = 9.592

*Shumëzon:*

9.15 (nota në provimin e formimit teorik profesional) x 1.1 (koeficienti për llojin e shkollës) = 10.065

Veprimi i dytë:

**Pastaj** ai sheh se cili është koeficienti që Fakulteti i Drejtësisë në Universitetin e Tiranës ka zgjedhur për lëndën Sociologji + Filozofi + Ekonomi Tregu. Ai gjen në tabele këtë koeficient: **1.3**

- Sociologji + Filozofi + Ekonomi: **koeficienti është 1.3**
- **Për Anglishten ai e di se koeficienti është 1.3, sepse në çdo rast kur zgjidhet anglishtja e ka koeficientin 1.3**

*Atëherë ai kryen edhe këto llogaritje te tjera:*

*Shumëzon:*

9.52 (nota në sociologji + filozofi + ekonomi tregu) x 1.3 (koeficienti për sociologji + filozofi + ekonomi tregu) = 12.376

*Shumëzon:*

$$9.23 \text{ (nota ne anglisht)} \times 1.3 \text{ (koeficienti për anglishten)} = 11.999$$

Veprimi tretë:

*Secili prej rezultateve **shumëzohet me 100:***

$$9.031 \times 100 = 903.1$$

$$9.592 \times 100 = 959.2$$

$$10.065 \times 100 = 1006.5$$

$$12.376 \times 100 = 1237.6$$

$$11.999 \times 100 = 1199.9$$

*Rezultatet mblidhen:*

$$903.1 + 959.2 + 1006.5 + 1237.6 + 1199.9 = 5306.3$$

*Ky është rezultati me të cilin Agimi konkurren për t'u pranuar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës.*